

VAHAN SETIAN

ORIGJINAT ARMENE TË BASKËVE



VAHAN SETIAN

ORIGJINAT ARMENE TË BASKËVE

Përktheu, përpunoi dhe përshtati për lexuesin Shqiptar
Berzh Piranjani



albPAPER
TIRANË, 2020

Përgatiti për shtyp: Berzh Piranjani

Redaktoi: Berzh Piranjani

Art Grafik: Orest Muça

Mundësuan botimin:

Berzh dhe Varuzhan Piranjani

Çdo përdorim ose ribotim i këtij libri për qëllime komerciale ndalohe.

Tirazhi 100 kopje

ISBN: 978-9928-05-268-1

Shtëpia Botuese “albPaper”, Tiranë, 2020

Rruga: “Shemsi Haka”, ish-Poligrafi ku, Tiranë

Tel.: +355 42 35 89 37

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Shënime paraprake për lexuesin shqiptar	5
Shënim i autorit	7
Rreth autorit	9
Dedikim.....	11
Shkurtime.....	12
Tabelat	13
Hyrje	14
Biografia e Vahan Sarkisian	21
Parathënie	23
Vendet baske dhe gjuha e tyre	29
Ngjashmëritë Baske – Armene dhe përtej tyre.....	33
Gabimet dhe Shmangiet	63
Gjuha dhe lufta e hipotezave.....	97
Përfundim	111
Dorëshkrimi i ardhshëm.....	119
(Shtojca 1) Tabela 11: Alfabeti Armen	121
(Shtojca 2) Alfabeti Armen dhe Transkripti	123
Hartë e krahinës Baske.....	125

SHËNIME PARAPRAKE PËR LEXUESIN SHQIPTAR

Gjatë punës për përkthimin dhe studimin e këtij materiali e pashë të arsyeshme t'i shërbej lexuesit dashamirës dhe mirëkuptues me ndërhyrje të miat në formë shënimesh sqaruese, pa cënuar origjinalitetin e idesë që ka dashur të na japë autori. Qëllimi i këtyre shënimeve është të qartësuarit apo të plotësuarit e materialit të trajtuar si përkthim dhe si përpunim e përshtatje njëkohësisht. Këto ndërhyrje qëndrojnë në sa më poshtë është paraqitur:

1. Me shkrim *Italics* kam vendosur elemente, që mendoj se duhen theksuar.

2. Me **yll* janë shënuar momentet, të cilat shoqërohen me shënime nga ana ime, shënime këto që vendosen pas shenjës së yllit ose në fund të faqes përkatëse në formën “*Shënim B.P.*”, që do të thotë *Shënim: Berzh Piranjani*”

3. Shënimet që i përkasin *Vahan Setian* janë paraqitur në formën: “*Shënim V.S.*”.

4. Numrat e shënimeve të V. Setian janë ruajtur, duke ruajtur kështu korrespondencën me librin original, tek i cili është bazuar përkthimi.

5. Tabela 1, 2, 6, 10 janë paraqitur në dy variante:

Varianti 1a, 2a, 6a, 10a – që janë kopje të përpikta të origjinalit të sjellë nga V. Setian

dhe

Varianti 1b, 2b, 6b, 10b – që janë materiali original i plotësuar me shkrimin në gjuhën Armene, transkriptimin dhe përkthimin e fjalës Armene në gjuhën Shqipe.

6. Ndër fjalët e ndodhura në tabelat sipërpërmendur, disa pak prej tyre janë vendosur me *y//; këto janë fjalë, të cilat unë nuk kam arritur t'i saktësoj me njohuritë dhe fjalorët e gjuhës Armene, që disponoj aktualisht.

7. Libri original i botuar nga V. Setian në gjuhën Angleze përmban disa kapituj dhe shtojca në gjuhën Angleze dhe Spanjolle, si edhe bibliografi të pasur, të cilat nuk janë përfshirë në këtë përkthim. Kjo me qëllim që ta lehtësonte lexuesin shqiptar nga materiale, që për momentin i gjykova jashtë sferës së tij të interesit.

8. Po kështu, me *y// janë shënuar edhe emrat e Historianëve, që shpesh janë pajisur edhe me një jetëshkrim të shkurtër.

Berzh Piranjani

SHËNIM I AUTORIT

I dashur lexues

Jam i bindur se do ta shijoni materialin e paraqitur në këtë dorëshkrim, që analizon ngjashmëritë e gjuhëve Baske dhe Armene. Jam, gjithashtu, i bindur, se ky material do të hedhë dritë mbi ato pak gjëra, që mund të kenë mbetur të patrazuara nga vitet. Kam marrë mesazhe mirënjohjeje në lidhje me botimin e këtij e këtij dorëshkrimi si edhe shprehje pakënaqësie nga të tjerë, që nuk e kishin parashikuar këtë lloj botimi. Shoqëria është e detyruar të mbështetet në informacionin, që i transmetohet asaj nëpërmjet burimeve, të cilat ajo është e kushtëzuar t'i pranojë si të pranueshme dhe të refuzojë burime të tjera, të cilat nuk përkojnë me pritshmëritë e tyre. Kjo ngurtësi ka shkaktuar pasoja të paimagjinueshme përkundrejt një bashkëpunimi të frutshëm e të shëndetshëm dhe në shkëmbimin e ideve ndërmjet gjithë mendjeve kërkuese, pavarësisht shoqatave apo përkatësive në vëllazëritë apo organizatat akademike. Në ndryshim nga shkencat e sakta, gjuhësia historike dhe krahasuese ka më tepër hapësirë për interpretim. Kjo ka lejuar që të jenë të shumtë ata, që kanë hyrë në këtë fushë me interpretimet tyre, që përmbajnë pak kërkime dhe verifikime. Ky mosbalancim, kryesisht i krijuar prej njerëzve me pozicion në akademi, ka dhënë rezultate të shtrembëruara, duke i bërë ato vështirësisht të korigjueshme. Pretendimi se uji përbëhet nga dy masa hidrogjen dhe një masë oksigjen mund të verifikohet në mënyrë të pavarur, pa pasur nevojën e mbështetjes nga autoritetet.

Sidoqoftë, gjuhësia historike dhe krahasuese ka nevojë të mbështetet ose të kundërshtohet nga disiplina të tjera siç është antropologjia, arkeologjia, biologjia evolutive dhe gjenetika e popullsisë. Është shumë interesant fakti, që shumë linguistë krahasues, duke filluar që 200 vjet më parë, kanë qenë kaq të kujdesshëm në deklaratat e tyre, sa që edhe sot teknologjia moderne dhe metodat kontrolluese vetëm sa i konfirmojnë ato. Por, siç duhet të jetë e bërë e njohur tashmë, domeni “gjuhësor dhe ai i historisë së lashtë” nuk është i lirë nga influencat gjeopolitike dhe paragjykimi akademik, të cilat janë forca që kanë krijuar disinformim dhe në një masë të madhe, falsifikim të historisë. Nëqoftëse mbështetemi vetëm në llogjikën, arësyen dhe racionalitetin, ne mund të nxjerrim shumë më tepër informacion nga të dhënat që na shfaqen përpara nesh sesa nga mbështetja në ato, që na vijnë nëpërmjet burimeve autoritare të pambështetura në sa më sipër. Për fat të keq, shumë marrin anën e këtyre të fundit, duke i paraprirë një perspektive pasurore ose materiale. Natyrisht, kjo nuk do të thotë që ne do të mbështesim një përçarje false, por vetëm të shprehim emergjencën intelektuale, që shqetëson si gjuhësinë historike dhe krahasuese ashtu edhe analizën e historisë së lashtë.

V. Setian


RRETH AUTORIT

Vahan Setian ka qenë duke analizuar civilizimin, gjuhën dhe mitologjinë botërore gjatë dekadës së fundit. Ai ka qenë intervistuar në një numër të madh programesh televizive dhe radiofonike. Ai ka kontribuar me artikuj mbi mitologjinë e lashtë, historinë e vjetër të Armenisë dhe gjuhën e saj. Në Qershor 2014, ai ishte i ftuar në radio-programin Suedez të njohur botërisht – Krijesat e Akullit të Kuq – ku pati një diskutim mbi temat e rrënjëve Armene të civilizimit, duke ngjallur një interes të shtuar në mbarë botën për rishikimin e gjuhëve Indo-Europiane dhe civilizimin botëror para-Kristian. Në datë 7 Shtator 2015 ai ishte i ftuar në orën e “Jimmy Church Radio” për të diskutuar rreth historisë dhe gjuhëve të lashta. Ai është autor i “Language as a Fingerprint - Gjuha si gjurmë gishtash”, i cili gëzoi një interes të madh dhe solli reagime të fuqishme në të gjithë botën.

DEDIKIM

Ky dorëshkrim i dedikohet kujtimit të dashur të Vahan Sarkisian (1954 - 2011), një akademik i shquar, Baskolog dhe linguist, i cili na la shumë shpejt, por duke na lënë pas një thesar të paçmueshëm me analiza linguistike të gjuhëve Armene dhe Baske, të cilat hodhën bazat për kërkime të mëtejshme në mbarë botën. Ky dorëshkrim është vetëm një kontribut i vockël ndaj veprës së tij monumentale.

V. Setian



SHKURTIME

Kuptimi në:

	<i>Anglisht</i>	<i>Shqip</i>
Aq.	Aquitanian	Akuitane
Arm.	Armenian	Armenisht
Basq.	Basque	Baskisht
BCE.	Before Common Era	para erës sonë (p.e.s.)
CE.	Common Era	era jonë (e.j.)
Cl.	Celtic	Keltisht
Eg.	Egyptian	Egjyptian
Etr.	Etruscan	Etruskisht
Hur.	Hurrian	Hurrian
IE.	Indo-European (Aryan)	Indo-European (Arian)
nIE.	Non-Indo-European	jo-Indo-European
Phr.	Phrygian	Frigian
PIE.	Proto- Indo-European	Proto- Indo-European
Vasc.	Basque (in Spanish literature)	Baskisht (në let. Spanjolle)
Ur.	Uratian (Araratian)	Urtiane (Araratiane)
Sum.	Sumerian	Sumeriane

TABELAT DHE FIGURAT

Tabela 1a	Paralelizmat Basko - Armene (në Spanjisht).....	37
Tabela 1b	Paralelizmat Basko - Armene (në Spanjisht).....	42
Tabela 2a	Paralelizmat e fjalëve të përcaktuara Basko - Armene	49
Tabela 2b	Paralelizmat e fjalëve të përcaktuara Basko - Armene	51
Tabela 3	Fjala – Aran	59
Tabela 4	Toponimet Basko-Armene.....	59
Figura 5	Dolmeni në vendet Baske	61
Tabela 6a	Paralelizmat Etrusko – Armene	65
Tabela 6b	Paralelizmat Etrusko – Armene	66
Figura 7	Vendbanimet Orontide. Shekulli i 5 ^{të}	71
Tabela 8	Paralelizmat e fjalëve Urartiano – Armene	75
Tabela 9	Paralelizmat Polineziano - Armene	86
Tabela 10a	Paralelizmat Sumeriano - Armene.....	88
Tabela 10b	Paralelizmat Sumeriano - Armene.....	88
Tabela 11	Alfabeti Armen	121

HYRJE

“Baskët janë një racë kozmike, që mund të gjendet në çdo kontinent dhe në çdo det, duke dhënë një shembull zelli, integriteti dhe modestie”

Jose Basconcelos

Tekst prej **Vahan Sarkisian**¹, Gjuhëtar dhe Baskolog Armen

“Nga fundi i shekullit të 19^ë linguisti Eduard Spenser Dodgson (Edward Spencer Dodgson, 1857-1922) ngeli i shtangur përpara një zbulimi intrigues. Studjues i njohur në fushën e studimeve Baske, Dodgsoni kishte filluar të mësonte gjuhën Armene për të zgjeruar horizontin e tij linguistik. Rezultati ishte krejt i papritur: pas vetëm dy muajsh, Dodgsoni vuri re që fjalë Baske dhe Armene ishin praktikisht njëllor. Dodgsoni i publikoi gjetjet e tij në vitin 1894 në revistën “Euskera” (Gjuha Baske). Ishin më tepër se 59 fjalë të përfshira në listën e Dodgsonit si fjalë të njëllorja. Kjo ishte si një bubullimë në qiell të kthjellët, veçanërisht për ata shkencëtarë që kishin mbështetur për një kohë të gjatë origjinën Gjeorgjiane të gjuhës Baske. Ky ishte një material me peshë në lidhje me një fjalor të rëndësishëm – tradicionalisht i konsideruar si bërthama (baza) e çdo gjuhe. Zbulimi i dytë i rëndësishëm, përta i takon lidhjeve etno-linguistike ndërmjet

¹ *Shënim V. Setian*: Ky është teksti i plotë, ku segmente të tij janë gjetur nëpërmjet Internetit, të përkthyer në gjuhë të ndryshme. Gjthashtu, është publikuar në Yerevan Magazine – Revista Jerevan)

Baskëve dhe Armenëve, u bë më 1920. Një filolog i ri Bask, Bernardo Estornes Lasa, i cili më pas u bë një shkencëtar dhe akademik i njohur, ishte duke mbledhur folklorin Bask. Në fshatin Isaba ai mori shënim një legjendë lokale (të zonës), e cila thoshte se Isaba ishte themeluar prej Armenëve, të cilët ishin banorët e parë të Navarros dhe paraardhësit e Baskëve. Sipas legjendës, udhëheqësi i popullit Bask quhej Haitor. Ai erdhi nga Armenia me shtatë djem dhe në nder të tyre, ai themeloi shtatë vendbanime në Navarra. Thuhej, gjithashtu, që paraardhësit Armenë të Baskëve dinin sekretin e përpunimit të metaleve. Më pas, një kronikë e lashtë e gjetur në arkivat e fshatit provonte vërtetësinë e legjendave gojore. Është shumë interesant fakti që, fjala “Isaba” do të thotë “gjurma e të parëve - gjurma e paraardhësve” dhe, sado e pabesueshme që të duket, akoma edhe në ditët e sotme, në fshat ndodhet një rrugë, që e quajnë - **Erminia**. Koincidenca të kësaj natyre do të dukeshin si zbulime të njerëzve Baskë, po të mos kishte qenë edhe demonstrimi i këtyre fakteve nga ana shkencore, veçanërisht nga shkenca e linguistikës, historiografisë dhe mitologjisë. P.sh., rezultoi që emri i patriarkut legjendar Bask, Haitor, mendohet të thotë “i ardhur nga Hai” ose “rrjedh nga Hai”, gjë që korrespondon saktësisht me grupfjalën Armene “Hai tor” (që do të thotë - *nip Hai* – ose – *nip Armen*, pasi Armenët e quajnë veten e tyre *Hai* ose *Ha*). Në mënyrë të ngjashme, termi Bask për prejardhjen racore (ose “racë e pastër”), “*haitoren seme*”, fjalë për fjalë do të thotë “*bir i Haitorit*”. Kjo do të thotë se në kohët e vjetra “racë e pastër” konsideroheshin vetëm ata që ishin pasardhës të drejtpërdrejtë nga Haitori.

Kërkime të mëtejshme çuan në zbulime shtesë, të cilat tregonin që faktet dhe koincidenat e sipërpërmendura përbënin vetëm majën eajsbergut të asaj, që konsiderohej sekretin më i madh i Baskëve. Siç u bë e qartë pas kësaj, teoria e origjinës Armene të Baskëve kishte rrënjë të thella në memorien kolektive të këtyre të fundit dhe ishte e reflektuar në burimet e tyre të shkruara. Duke filluar nga shekujt 16^{të} dhe 17^{të}, themeluesit e historiografisë Baske, Esteban de Garibai, Andres de Posa dhe Baltazar de Echave, morën në konsideratë Armeninë si atdheun

origjinal të Baskëve dhe u përpoqën ta argumentojnë këtë mbi bazën e paralelizmave (ngjashmërive) toponimike ndërmjet gjuhëve Armene dhe Baske. Për më tepër, de Posa këmbëngulte që Baskët ishin të porsaardhur nga Armenia. Ai bile demonstroi që ishin Armenët ata që themeluan qytetin e Tarragonës², në brigjet Spanjolle mesdhetare. Fjala “Tarragona” është reminishencë e krahinës Armene të Taron-it, forma e lashtë e të cilit është “Tarvana”. Historiani Spanjoll i shekullit të 17^{të} Gaspar Escolano është një burim tjetër i rëndësishëm. Në studimin e tij për historinë e Valencias, të publikuar në 1610, ai shkruan se duke ndjekur vërshimin e madh, patriarku Tubal dhe populli i tij, i cili u vendos në bregun lindor të Spanjës, flisnin Armenisht.

Për më tepër, Escolano përshkruan vendet e sakta ku legjenda thotë se janë varrosur banorët e parë Armenë në Spanjë. Sot këto vende, kryesisht në Katalonia, përfshirë një grumbull mbeturina kishash (*a sting of churches ??*), që tregojnë se këto vende kanë qenë trajtuar si të shenjta qysh nga kohët e lashta.

Për fat të keq, i gjithë ky informacion është neglizhuar për një kohë të gjatë. Për më tepër, kur në vitin 1928 linguisti Gjerman Josef Karst botoi rezultatet e këtij kërkimi të zgjeruar (Karst, 1928) duke paraqitur më shumë se 300 përputhje linguistike Basko-Armene dhe një numër të konsiderueshëm ngjashmëri në fonetikë dhe gramatikë, përfshirë edhe një sistem të përbashkët zgjedhimi, ai u kundërshtua ashpërsisht nga gjuhëtarët e rrymës kryesore. Karsti guxoi të rishikojë

² *Shënim V. Setian*: Tarragona² – Tarragona është kryeqyteti i krahinës së Tarragonës, dhe pjesë e Tarragonës dhe Katalonjës. Emri Tarragona ka tërhequr vëmendjen për shkak të etimologjisë së saj. Ka opinione të ndryshme. Sir William Smith (1813-1893), një leksikograf Anglez, thotë që ai është quajtur Tarchon nga Fenikasit. Një interpretim biblik përpiket ta lidhë atë me “Tarraho”, djali i madh i Tubalit, që ishte një prej bijve të Xhafetit (Japheth). Një tjetër variant e lidh atë me “Taharqa”, një faraon Egjiptian, për të cilin thuhet se kishte guxuar të lundronte deri në Spanjë. Sidoqoftë, për aq sa unë di, askush nuk na siguron neve një rrënjë etimologjike si një përkufizim përshkrues me përjashtim të gjuhës Armene. Tarragona mund të ketë prejardhur nga fjala Armene “Tarragnats” - , që do të thotë “një person i larguar nga atdheu i tij për t’u vendosur në një vend të huaj”, shkurt “mërgimtar, emigrant”.

hartën gjuhësore të Europës, duke hedhur dyshime mbi konsiderata tradicionale. Gjuha Armene ishte konsideruar Indo-Europiane ndërsa ajo Baske jo, kështu që qindra koincidenca, legjenda popullore, dhe të dhëna historike dilnin pa kuptim.

Sido që ta lije, materiali i bollshëm i ngjashmërive (paralelizmave) ndërmjet gjuhës Armene dhe asaj Baske kërkonin një analizë dhe interpretim të rreptë. Kërkimet bashkëkohore kishin nevojë për vazhdimësi. Duke pasur këtë në mendje, në vitin 1993, Katedra e Armenologjisë e Universitetit Shtetëror të Erevanit publikoi revistën “Araks”, një revistë shkencore Armeno-Baske, redaksia e së cilës përfshinte shumë Armenologë të famshëm dhe ekspertë Baskë nga vende të ndryshme. “Araks” ka publikuar rreth 30 artikuj mbi çështje, që trajtojnë probleme linguistike, mitologjike, etnografike dhe historike. Programi Armeno-Bask i Universitetit Shtetëror të Erevanit është zbatuar në bashkëpunim të ngushtë me organizata të ngjashme në vendet Baske dhe në Francë (Gaskoni). Kërkimi i tyre ka rezultuar në si më poshtë:

1 Shkencëtarët kanë zhvilluar listën më të plotë deri më sot me ngjashmëritë linguistike Baske, duke përfshirë më se 1000 fjalë dhe elemente gramatikorë. Realisht, kërkimi ka treguar që çdokush mund të formojë një numër të madh fjalish si në gjuhën Armene ashtu edhe atë Baske, të cilat mund të kuptohen si nga folësit e njerës gjuhë ashtu edhe nga folësit e gjuhës tjetër. Ngjashmëri (paralelizma) të tilla të forta nuk mund të konsiderohen si aksident. Për më tepër që, mundësia e huazimit nga njera tjetra është përjashtuar për shkak të largësisë së madhe, që i ndan këto dy kombe dhe vende.

2 Fshatrat e Malësive Armene dhe Baske kanë të përbashkëta disa fjalë toponimike. Në të shkuarën, ngjashmëri të tilla nuk mendohej që të përbënin ndonjë fakt shkencor, bazuar në faktin që një grup tjetër krahinash kishin të përbashkëta fjalë, që tingëllonin njëllë, por kishin kuptime të ndryshme. Sidoqoftë, paralelizmat toponimike Armeno-Baske kanë një veçori të rëndësishme: në shumicën e rasteve ato kanë të njëjtin kuptim. Si shembull mund të shërbejnë fjalët:

“aran” (luginë-si në gjuhën Armene ashtu edhe në atë Baske);

“karbi” (Armenisht – nën gur), “karbe”(Baskisht - nën gur);

“tsaval, caval” (Armenisht - zgjerim), “sabal” (Baskisht - gjerësi)

3 Në dritën e traditave folklorike Baske që flasin për Armeninë si atdheu i origjinës dhe që bëjnë fjalë për paraardhësit Armenë, të cilët dinin sekretin e përpunimit të metaleve, studjuesit zbuluan edhe ngjashmëri të tjera etimologjike. Kështu fjala “Euskaldunak”, e cila nënkupton në Baskisht fjalën “vetveten, veten e tyre, etj”, vjen nga fjala rrënjë “eusk” (“usk”, “esku”, “ask” në dialekte të ndryshme). Kjo rrënjë është e lidhur etimologjikisht me fjalën Armene “voski” (ar) dhe variantet e saj “iski”, “veske”, “aski”, etj. “Voski” është gjithashtu rrënja e emrit të përveçëm Voskan, që nënkupton “njeri që zotëron ar” dhe është reminishencë e fjalës Baske “Baskon” (“Vaskon” – në burimet latine). Vlen të përmendet, që gjatë epokës së Mbretërisë Urartu, bregu juglindor i Liqenit Van, d.m. th. djepi i kombit Armen, ka qenë quajtur Khubushkia, e cila fjalë për fjalë do të thotë “luginë e usks”, ose “luginë e artë”. Në burimet Armene të mesjetës së hershme, krahina nuk quhej më ashtu. Emri i ri ishte “Hayots Dzor (Hajoc xor)”, që nënkuptonte “Luginë e Armenëve” ose “Luginë Armene”. Nga ana tjetër, mbishkrimet Urartu përmendin malet e Ushkianit në bregun verilindor të Liqenit Urmia. Në kohën e gjeografit grek Strabo malet e Ushkianit quheshin “Malësitë Armene” dhe në burimet pasuese Armene ato njihen si “Voskian” (të arta). Të gjitha këto fakte na çojnë neve në përfundimin që për paraardhësit tanë nocionet “minator ari” dhe “Armen” kanë qenë sinonime, gjë që konfirmohet nga legjendat Baske.

Natyrisht, askush nuk mund të thotë që të gjitha çështjet, që lidhen me teorinë e afërisë Basko-Armene, janë të zgjidhura përfundimisht, por pika kryesore mbetet përtej çdo dyshimi: që civilizimi Bask pëmban një shtresë të thellë Armene si rezultat i procesit të migrimit në kohë prehistorike. Njihet gjerësisht që Baskët janë populli më i vjetër i Europës Perëndimore. Ata u shfaqën përpara se të mbërrinin Indo-Europianët, me invazionet fillestare që datojnë rreth viteve 1000

BC (para Krishtit). Duke filluar prej asaj kohe elementi Armen tashmë ekzistonte në Europën Perëndimore dhe rrjedhimisht pati një influencë të dukshme në zhvillimin e civilizimit European. Legjendat popullore Baske flasin për “basaunët”, figura mitologjike të jashtëzakonshme, që ishin zotëruesit e pyjeve dhe jetonin të veçuar, larg prej njerëzve të zakonshëm. Karakteristika të ngjashme ekzistojnë në mitologjitë e kombeve të ndryshme, por “basaunët” Baskë shfaqen me një karakteristikë unike: ata njohin procesin e përpunimit të metaleve dhe kultivimit të grurit. Ka shumë të ngjarë, në një pikë të caktuar, mitologjia pasqyron ngjarje historike. Përfytyrimi i gjigantëve të padjallëzuar të pyjeve mund të ketë ekzistuar në mitologjinë lokale përpara arritjes së Armenëve. Në kohë të mëvonshme, Armenët e ngulitur, të cilët dinin sekretin e përpunimit të metaleve dhe të kultivimit të grurit, të jenë barazuar me “basaunët”, pasi njerëz të aftë për përpunimin e metaleve dhe kultivimin e grurit fare mirë mund të konsideroheshin mbinatyrorë. Kështu, krahas gjuhës, Armenët duket të kenë sjellë në Europë, gjithashtu, edhe zhvillime industriale thelbësore. Ja përse nuk është e rastësishme që gjuhët Armene dhe Baske kanë një numër të konsiderueshëm fjalësh të ngjashme në agrikulturë. Siç nxjerrin në dukje edhe zbulimet arkeologjike mbi shfaqje Armenoide në Gadishullin Pirene në Mileniumin e Tretë BC, e vetmja logjikë do të ishte të pranohet që Baskët janë Armenoidë në origjinë. Kjo hipotezë është shtyrë akoma më përpara nga kërkimet gjenetike të kohëve të fundit, të cilat sjellin në këtë histori një ndërthurje të papritur dhe interesante. *Është fakt i ditur se Armenët kanë një problem lidhur me dhurimin e palcës. Me fjalë të tjera, një personi Armen mund t'i transplatohet vetëm palca e një personi po Armen.* Kjo është arsyeja që shkencëtarët kanë qenë të angazhuar në kërkimet për krijimin e indeve të krahasueshme me ato Armene. Ajo, çfarë ata kanë zbuluar, rezulton në atë, që përbërja indore - palcore Baske është më afër asaj Armene në krahasim me të tjerat. Siç thotë proverbi Bask “Vet-njohja është shkencë e vërtetë”.

Vahan Sarkisian (1954 - 2011)

BIOGRAFIA E VAHAN SARKISIAN

Vahan Sarkisian ka lindur në Erevan në vitin 1957. Ai studjoi në Universitetin e Erevanit në degën Filologji Romane (Latine) dhe mbrojti tezën e doktoraturës mbi afërsitë lingustike Basko-Armene. Ai shërbeu si drejtor i Katedrës Filologji Romane në Universitetin e Erevanit, si President i Akademisë Gjuhësore Ndërkombëtare, antar i Shoqatës Ndërkombëtare të Hispanikëve, si edhe drejtor i revistës internacionale Basko-Armene “Arakses” dhe akademik nderi i Euskaltzindia. Ai bëri përkthime të shumta nga gjuha Spanjolle dhe ajo Baske në gjuhën Armene, si edhe hartoi Fjalorin Basko-Armen si edhe një gramatikë të gjuhës Baske në gjuhën e tij.

Kur një Armen arrin në vendet Baske,
duket sikur muret diç duan t'i thonë.

Vahan Sarkisian

PARATHËNIE

“Dielli nuk qëndron pas reve”

Proverb Armen

Në çdo fushë studimi, në rastin tonë konkretisht në gjuhësinë historike dhe krahasuese dhe në historinë e lashtë, ekziston një betejë e përhershme midis ekspertëve, që përpiqen të gjejnë fakte për të mbështetur hipotezat e tyre, ose edhe që vetëm për hir të sinqeritetit intelektual, të paktën të shprehin atë, që kanë zbuluar me rezultatet e kërkimeve të tyre, dhe që në një masë të konsiderueshme shërbejnë për të shmangur hapësirat për spekulime. Ndërkohë që kjo betejë vazhdon, ka fusha të tjera, të cilat duhet, mundet dhe do të plotësonin fushën e gjuhësisë, siç mund të jenë antropologjia dhe arkeologjia, duke rritur në një shkallë më të lartë interesin për gjuhësinë dhe historinë e lashtë. Ky nocion i “rregullit brenda kaosit”, apo “kaosit brenda rregullit”, pavarësisht këndvështrimit individual arrin deri tek media dhe letërsia dominuese, duke arritur së fundmi në dhënien formë të perspektivës së njerëzve mbi këtë subjekt, duke qenë se ata përzgjedhin dhe ruajnë vetëm ato pjesë që përmbushin interesat e tyre dhe e lënë mënjanë pjesën tjetër. Eventualisht, blogjet e ndryshme dhe faqet e internetit do të reflektojnë filtrimin e mëtejshëm të ideve tashmë të filtruara më parë, duke u bërë së fundmi të pa krahasueshme me përfundimet e burimeve fillestare. Por në të njëjtën kohë, ne përballemi me një problem po aq të madh: Si e vërtetojmë se burimet fillestare reflektojnë të vërtetën

mbi subjektin (çështjen, temën) në fjalë? Për këtë arsye është e rëndësishme të shtrohen pyetjet si vijon:

Si e dimë çfarë dimë rreth një subjekti?

Si e vërtetojmë që dimë mjaftueshëm, me qëllim që të mësojmë atë, që duhet të dimë në lidhje me një subjekt?

Si e kuptojmë se na ka shpëtuar pa vënë re apo kemi neglizhuar një perspektivë, e cila na ndihmon të kuptojmë një subjekt të caktuar?

Këto pyetje do e përshkojnë këtë dorëshkrim për rishikimin e marrëdhënies dhe paralelizmave midis gjuhës Baske dhe asaj Armene. Ky punim përmban një pasqyrim të kërkimeve të hershme dhe atyre bashkëkohore mbi këto paralelizma dhe tregues të atyre studjuesve, që kanë gjetur lidhje të forta midis gjuhëve dhe në të njëjtën kohë nxjerr në pah ato studime, të cilave këto paralelizma i kanë shpëtuar, duke çuar në konkluzione të mangëta dhe ndonjëherë të gabuara. Ky dorëshkrim gjithashtu e mbështet me literaturë të rrallë trajtimin e kësaj çështjeje, të cilën shpresoj që lexuesi do ta marrë në konsideratë.

Qëllimi i këtij dorëshkrimi është zbulimi i informacioneve, të cilat mund të merren në konsideratë si nga referuesi ashtu edhe akademiku në lidhje me këtë subjekt intrigues, ndërkohë që shërben si një platformë edukuese për t'u marrë në konsideratë nga institucionet dhe deri në një farë pike për të rishikuar nocionet e tyre në lidhje me këtë temë. Ky synon të përmbushë dy objektiva të mëtejshme. Së pari, është pasurimi i sasisë aktuale të njohurisë mbi këtë subjekt dhe të ndihmojë lexuesin të reflektojë mbi materialin e pranishëm në këto faqe. Njohuria e pranishme është e mbushur me opinione të gabuara dhe ato janë tejet alarmante nëse do të mbeteshin në të njëjtën gjendje. Kështu, del nevoja për të siguruar për gjeneratat e ardhshme dhe ato aktuale informacion më të saktë në lidhje me këtë subjekt, të paktën për të respektuar njerëzit e lashtë Baskë dhe Armenë. Paralelizmat pohues Baskë-Armenë nuk duhet të shndërrohen në një objekt debati, por më tepër në objekt shqetësimi, se si paralelizma kaq të dukshme, të cilat duhet të merren në konsideratë pa asnjë lloj dyshimi, mungojnë

nga faqet e akademisë në përgjithësi. Së dyti, është që të shtrojë një sfidë ndaj gjuhëtarëve, statisticienëve dhe matematicienëve për të ekzaminuar lidhjen e pashmangshme midis gjuhës Baske dhe asaj Armene, e cila për aq sa unë kam arritur të zbuloj, nuk mund të kundërshtohet as matematikisht as edhe nga ana gjuhësore. Edhe nëse ne lejojmë kërkuesit të studiojnë vetëm paralelizmat gjuhësore ndërmjet këtyre dy gjuhëve, ata nuk do të arrijnë në konkluzion tjetër përveçse në një qëndrim pohues.

Problemi i parë dhe më i rëndësishëm, të cilin hasin studimet gjuhësore dhe ato të historisë së lashtë, është problemi i metodave të studimeve gjuhësore dhe të historisë së lashtë. Me fjalë të tjera, shtrimi i çështjeve në mënyrë të gabuar apo formulimi i një hipoteze të pasaktë përcakton rrugën dhe konkluzionin në të cilin arrihet, i cili mund të jetë ndryshimi midis një zbulimi dhe një marrëzie akademike. Prandaj mund të mendohet se vetë akademikët, në pozicionin e tyre prej eksperti, janë shkelësit dhe shpëtimtarët më të mëdhenj. Rendi kronologjik i gabimeve me ndikim, anashkalimi i paralelizmave të dukshme, padija e qëllimshme, deformimet dhe pandershmëria intelektuale pushton faqet e shumta të librave dhe shkrimeve, ndërkohë që këto të fundit vihen në dispozicion të shkollave dhe universiteteve. Për pjesën më të madhe, fusha e gjuhësisë dhe historisë së lashtë, me aq sa kam vënë re, është më pak e bazuar në pranimin e fakteve të dukshme dhe të padeformuara dhe më tepër në pranimin e ndonjë pranimi tjetër, opinioneve të çuditshme të ngurtësuara deri në thelbin e tyre, dhe të përjetësuara nga kurrikulat e fozilizuara në brendësi të institucioneve statike. Megjithatë, është e mahnitshme të vihet re se sa më të arsyeshme dhe racionale do të ishin konkluzionet e kërkimeve tona, nëse ne arrijmë të hedhim një vështrim përtej kësaj perdeje, që mbulon horizontin tonë të gjykit të pastër. Dhe kjo do të ishte një tjetër arsye se, përse shqyrtimi dhe analiza e marrëdhënies midis gjuhës Baske dhe asaj Armene bëhen të domosdoshme.

Mundësia për të shkruar mbi gjuhën dhe historinë, sigurisht mund të shoqërohet nga një punë voluminoze, çdo temë dhe nëntemë

respektive arrin të shtrihet më gjatë dhe më gjerë, me një mundësi të shkëlqyer për të gërmuar më thellë në një rrjetë informacioni, për të cilin një jetë e tërë do të rezultonte e pamjaftueshme. Megjithatë, në këtë dorëshkrim, ne i kemi vënë vetes detyrë t'i përgjigjemi disa pyetjeve specifike:

A ka paralelizma gjuhësore Baske-Armene dhe sa të rëndësishme janë ato?

Çfarë dihet deri tani bazuar në kërkimet e kryera në të shkuarën dhe ato aktuale?

Cilat do të jenë ndikimet e zbulimeve tona në kërkimet e mëtejshme?

Niveli i mungesës në përgjithësi i paralelizmave të dukshme midis gjuhës Baske dhe Armene ishte ajo, që më shtyu jo vetëm të hetoj mbi atë që kanë shkruar kërkuesit dhe gjuhëtarët në histori, por edhe që të kërkoj prova të mëtejshme në lidhje me këtë temë. Ajo që duhet të dimë në lidhje me paralelizmat Baske-Armene, do të na drejtojë që të kërkojmë më thellë në të shkuarën e lashtë, duke u bazuar në rishqyrtimin e literaturave, të cilat i anashkalojnë apo i deformojnë faktet, ndërkohë që, duke rishkruar literaturën aktuale, bëhet e mundur që të reflektohen faktet, të cilat ky subjekt i meriton. Vetëm një ndërmarrje e tillë hap një forum diskutimi të gjerë në lidhje me historinë e lashtë, gjuhësinë krahasuese, studimet Indo-Europiane (IE) dhe jo-Indo-Europiane (nIE), antropologjinë kulturore dhe gjenetikën e popujve. Në këtë dorëshkrim është menduar të mos mërzhitet lexuesi me detaje të tepërta, megjithatë është i domosdoshëm parashtrimi i informacioneve të rëndësishme, duke mundësuar që vetë materiali të pasqyrohet në formën e vet origjinale. Unë besoj tek arkitekti i famshëm Amerikan, Frank Lloyd Wright (1867-1958), që dikur tha: “gjëja më e vështirë është t'i bësh gjërat e thjeshta”. Për qëllimet e këtij dorëshkrimi, një nga prioritetet kryesore është të bëhen gjërat sa më të thjeshta për t'u kuptuar, ndërkohë që, integriteti i tërësisë të ruhet i paprekur. Faktikisht, sa më e madhe ishte përpjekja për të ruajtur

thjeshtësinë e gjërave, aq më të qarta ishin zbulimet e kërkimeve mbi këtë çështje, duke mundësuar eliminimin e sasive të mëdha të hirit dhe detajeve të panevojshme në favor të hapjes së një perspektive më të mirë, të krijimit të një vizioni më të qartë dhe për të arritur në konkluzionin e pashmangshëm se, Vahan Sarkisian kishte pasur të drejtë gjatë gjithë kohës.

VENDET BASKE DHE GJUHA E TYRE

“Gjuha Baske është dëshpërimi i studjuesve dhe më misteriozja nga të gjitha gjuhët e njohura”

Aldous HUXLEY (Novelist dhe Eseist Anglez, 1894 - 1963)

Thuhet që gjuha Baske është një enigmë gjuhësore dhe historike. Baskët janë një popull, që banojnë në një rajon në Gjirin e Biskajës në Spanjë dhe Francë dhe përdorin një gjuhë, të cilës nuk i njihen rrënjët, pasi ajo nuk ka lidhje me asnjë gjuhë tjetër që flitet deri më sot dhe nuk ka asnjë teori, që të konfirmojë lidhjen e saj me ndonjë gjuhë të përafërt (Boise State University: Basque Studies).

Përveç kësaj, fjalët e para të shkruara me referenca Baske janë gjetur në pllakat e varreve (stelave) Basko-Aquitane dhe Pireneane, të cilat datojnë që nga shekulli i I^{rë} i erës sonë të kohës Romake, ndërsa fjalitë e lidhura (*bëhet fjalë për fjali të lidhura gramatike: Shënim B.P.*) më të vjetra datojnë që nga shekulli i 10^{të} i erës sonë. Kjo është një nga arsyet që Baskët janë konsideruar banorë autoktonë në vendet Baske, një rajon që përfshin Pirrenejtë më perëndimorë, ngjitur me Spanjën veriore dhe Francën jugperëndimore. Populli Bask e quan veten e vet *Euskaldunak* “folës të gjuhës Baske”, fjalë kjo e prejardhur nga *Euskara* “gjuha Baske” dhe – *dun* “ai që ka” si tek fjala “ai, që flet gjuhën Baske”. Dhe e quajnë vendin e tyre *Euskal Herria*. Iparralde (fjalë për fjalë, “pjesa veriore” e Baskëve), gjithashtu e njohur si vendi Bask

Francez, ose *Euskal Herria kontinentale*, përfshin territoret e Lapurdisë (Labourd në Frengjisht), Zuberoa (Soule) dhe Behenafarroa (gjithashtu e njohur si Navarra e Poshtme ose Navarra e Ulët në Francë). Qytetet kryesore janë, respektivisht, Baiona (Bayonne), Maule dhe Donibane Garazi (Saint Jean Pied de Port). Dy nga këto krahina administrative, Komuniteti Autonom i Euskadit dhe Komuniteti Autonom i Navarrës ndodhen në Hegoalde, pjesa jugore në Euskara ose gadishullin Euskal Herria. Ato janë pjesë e Shtetit Spanjoll ose Spanjës, ndërsa Iparralde i përket Republikës Franceze ose Francës. Pra, Euskal Herria është një kombinim i këtyre 3 njësive administrative ose i shtatë territoreve, në fakt gjashtë nëse kombinojmë dy Navarrat- Navarrën dhe Navarrën e Poshtme (Zallo & Ayuso, 2009). Në një libërth dore (doracak) të përgatitur për llogari të qeverisë Baske për imigrantët, pasardhës të diasporës Baske dhe për vizitorët, Zallo & Ayso konfirmojnë që “mbetjet e lashta të zbuluara në vendet Baske përbëhen prej gurësh, që datojnë që nga periudha paleolitike. Për më tepër, janë gjetur edhe nofulla Neandertali dhe objekte të tjera, por akoma më tepër objekte, që datojnë të një periudhe akoma më të hershme, deri të periudhës së Cro-Magnon-it. Mbeturina prej kësaj periudhe, përfshirë edhe piktura në muret e guvave (shpellave), janë gjetur në guvat e Ekain, Altxeri (Altxerri), Santimamine dhe Alberdi. Periudha Neolitike ndërmjet 4500 dhe 2500 vjet p.e.s (para erës sonë) solli një numër të madh ndryshimesh në mënyrën e jetesës së popujve, gjatë së cilës banorët filluan të ndërtonin vendbanime, të punonin tokën dhe të mbarështonin bagëtinë.

Ata kaluan nga stadi i të qenit nomadikë (endacakë) në sedentarë (të ngulitur, të ndenjor) dhe në momentin që arritën moshën e bakrit dhe të bronzit, 2500-900 vjet p.e.s, populli filloi të përpunojë metalet dhe shoqëria u bë më e organizuar. Duke qënë se pjesa veriore e Euskal Herrias ishte më e izoluar, ajo u zhvillua më ngadalë se pjesa jugore. E njëjta gjë ndodhi edhe gjatë periudhës Romake. Në kohët e lashta, Euskal Herria dhe zonat përreth banoheshin prej paraardhësve të Baskëve: Autrigoët, Karistët (Caristi), Vardullët dhe Vaskonët, të

cilët historiani Grek, Straboni, i konsideronte të egjër dhe luftëtarë (fq.10). Duke ju referuar pyetsorit “Pyetje dhe Përgjigje” të Universitetit Shtetëror të Boise mbi gjuhën Baske (Boise State University, Basque Studies), ai tregon që “ky është një rast i pazakontë i një populli, që e emëron vetveten sipas gjuhës që flet”. Libri i parë i shkruar në Euskara i përket Bernard Etxepare (Etxepare) në vitin 1545, i cili përmbante një përmbledhje poemash.

Euskara ka 8 dialekte krahinore dhe 24 nëndialekte, duke diktuar kështu nevojën për standartizimin e gjuhës, duke krijuar atë, që tashmë njihet si ‘euskara batua’ (Euskara e unifikuar) në vitin 1968 (Boise State University, Basque Studies). Campbell (2008) listoi dialektet si më poshtë vijon⁶:

- Bizkaiera (Vizcaíno, Viscayan);
- Nafarrera garaia (High Navarro);
- Salazarera (Salacenco);
- Lapurtera (Laburdino, Labourdin);
- Zuberoa (Suletino, Souletin);
- Gipuzkera (Guipuzcoano);
- Aezkera (Aezcoan);
- Erronkaria (Roncalese);
- Nafarrera behera (Low Navarro);

Një gjuhë e dhënë, që ka një bollëk dialektesh, nënkupton që ka një hapësirë të gjerë për moskuptim të ndërsjelltë. E njëjta gjë mund të thuhet për gjuhën Baske. Kështu, një fjalë që i përket një objekti në një dialekt të caktuar, mund të ketë një kuptim të ndryshëm dhe plotësisht të panjohur për një dialekt tjetër. Kurlansky (2008) pohoi që, Baskët janë populli më

⁶ *Shënim V. Setian*: Forni (2014), përveç atyre të listës kishte edhe dialektin jugor të Alavës

i vjetër i Europës, origjina e tyre është një mister, dhe gjuha e tyre nuk ka lidhje me asnjë gjuhë tjetër në botë. Sidoqoftë, ne jemi duke asistuar në rezultate të kërkimeve të shumta, që tentojnë të ndihmojnë Baskët për ta parë gjuhën e tyre jo si një gjuhë të izoluar, ose popullin Bask si të izoluar nga të tjerët, por si pjesë të një migrimi gjuhësor nga Lindja e Afërme dhe si pjesë të zhvillimit të civilizimit njerëzor duke filluar nga Last Ice Age*. Pjesa tjetër e dorëshkrimit do të na japë neve arsyet përse ky rast mund të jetë i mundur.

* *Shënim B.P.* Periudha e fundit e akullnajave ndodhi nga fundi i Eemianit deri në fundin e Driasit të Ri, duke përfshirë periudhën rreth 115,000 – deri rreth 11,700 vjet më parë .

NGJASHMËRITË BASKO – ARMENE DHE PËRTEJ TYRE

“E vërteta do t’ju çlirojë, por fillimisht do t’ju acarojë”

Joe KLASS

Në strukturën e literaturës mbi paralelizmin e gjuhëve Baske-Armene ekziston më tepër literaturë në mbështetje të kësaj teorie, se argumente kundër saj, dhe ne arrijmë në një situatë tepër të parehatshme, ku kuptojmë, se po merremi me një mungesë të dyshimtë të materialeve mbështetëse mbi këtë teori në rrjedhën akademike aktuale. Ne mund të fillojmë prej çdo pike, kështu që, le të fillojmë me Mark Kurlanskin, autorin e librit *“Bota Baske”*. Ai e filloi karrierën e tij si një korrespondent i huaj, duke shkruajtur rreth viteve të fundit të ndikimit francez në Spanjë, veçanërisht në provincat Baske, dhe pati rastin t’i vizitojë ato çdo vit për të paktën njëzet e pesë vitet e fundit. Le të presupozojmë, se ai pati një rast të dorës së parë për të ekzaminuar kulturën Baske, gjuhën, trashëgiminë, emrat gjeografikë të liqeneve dhe të maleve në krahinën Baske. Bazuar në këtë material të akumuluar, ne do të duhej të prisnim një reflektim të madh dhe domethënës nga ana e tij mbi emërtimet dhe vendet, emrat e shumë lumenjve, liqeneve, rrugëve dhe maleve, të cilët shkojnë paralel dhe janë një pasqyrim i saktë i lumenjve, emrave të vendeve dhe emrave të maleve në Armeni. Ne, gjithashtu, do të duhej të prisnim disa forma njohjeje në ngjashmëri të tregimeve folklorike dhe pretendimeve të historianëve lidhur me të dy kulturat. Por nuk është ky rasti, që

kërkojmë të trajtojmë në këtë libër. Së pari, autori reflekton në mitin, sipas të cilit Basku i parë ishte ‘Aitor’, gjë të cilën ai pretendon se është krijuar në vitin 1848 prej shkrimtarit basko-francez Augustin Chaho (Çaho). Pas vdekjes së Chaho, artikulli u përkthye në Spanjisht në vitin 1878, duke e zbukuruar legjendën akoma më tepër dhe duke e bërë atë pjesë të kulturës Baske. Për çdokënd do të ishte shumë e dyshimtë që Chaho të ketë krijuar termin “Aitor” ose “Haytor” për shkak të Bernardo Lasa, një shkencëtar dhe akademik i shquar, i cili grumbulloi tregimet e folklorit Bask në Navarra, dhe më specifikisht, në luginën Rapkal, dhe gjeti pohime mbi të kundërtën. Për shembull, në fshatin e Isba ai zbuloi një legjendë lokale, që tregonte se si fshati ishte themeluar prej Armenëve, banorëve të parë të Navarrës, të cilët qenë konsideruar si paraardhësit e popullit Bask. Legjenda flet për Haytor si udhëheqës i Baskëve i cili arriti atje nga Armenia me shtatë fëmijët e tij. Vetëm në gjuhën Armene fjala “*haytor*” do të thotë “*nip Armen*”.

Baskët kanë këngë popullore, që shprehin konceptin e kohëve Haj në lirikat e tyre, këngë të zonave fshatare ku ne mund të gjejmë ata, të cilët mund ta mbajnë gjallë këtë histori të lashtë. Përveç kësaj, brenda legjendave Armene, Hajku i Armenëve ka një nip, emri i të cilit është Pask ose Bask. Për më tepër, jo vetëm që ekziston një rrugë me emrin “Erminia”, që përkthehet në Baskisht “gjurma (rruga) e paraardhësve tanë”, por edhe një mbiemër – *Armentor*. Në librin e tij “Historia e Armenisë”, Moisi Khorenaci (Moses of Khoren, Moses of Choren, Moses Chorenensis), që ishte një historian i njohur Armen, thotë: “...nga gjenerata e Basqamit, nipit të Hajkut, rrjedh edhe emri i tij Tork...” (fq. 89).

*Հայկազկի թոռնն Պապաւմի սէրնդից եւ աւունւր Տորք**

Khorenaci, në librin e tij të I^{re}, gjithashtu pohon: “...Shtëpia e Angegh (*Angegh - hutë*) rrjedh nga një nip i Hajkut, i quajtur Baskam”.

* *Shënim B.P.* Transkript fjalë për fjalë:

(Arm. Lindor: Hajkaki torrn Paskami serndic jev anunë Tork)

(Arm. Perëndimor: Hajgagi torrn Baskami serntic jev anunë Dork)

Pra, ai përmend Baskam dhe Hajk rreth 1400 vjet përpara publikimit të vitit 1848. Kështu, që do të ishte shumë e pamundur, që Chaho të dinte diçka rreth këtyre lidhjeve ndërmjet legjendave Baske dhe Armene. Po kështu, edhe Kurlanski përsëriti pikëpamjet e Chaho-s në librin e tij, duke treguar që ai nuk dinte gjësendi rreth këtyre temave të ndryshme. Edhe nëqoftëse ne i konsiderojmë këto tregime si mite apo legjenda, ne nuk mund t'i shmangemi dot fakteve me të cilat etimologjia Armene i rrethon këto terma. Kështu, gjuha është për ne si gjurma e gishtit dhe duhet përdorur si busull. Kurlanski përmend Esteban de Garibai dhe Zamalloa (1533-1599)*, një historian Spanjoll i shekullit të 16^{të}, por nuk përmend, që ai kishte vërejtur, që emrat e vendeve Baske përmbanin ngjashmëri me ato të vendeve në Armeni.

Garibai⁸ gjeti shfaqje të ngjashmërive ndërmjet emrave të vendeve në Spanjën veriore dhe në Armeni, siç ishte Mali Araler në Armeni dhe Mali Aralar⁹, vargmali në Gipuzkoa dhe Navarra. Ai lidh, gjithashtu, malin Bask të Gorbeias me majën Armene “Gordeia”. Kurlanski lë mënjanë këtë lidhje të rëndësishme ndërmjet dy gjuhëve dhe kulturave të tyre, dhe kompletton një dorëshkrim të tërë, pa sjellë një konkluzion konkret mbi atë, se kush janë Baskët, një analizë domethënëse të gjuhës ose të ngjashmërive, dhe nuk përmend disa nga analizat më të thelluara rreth gjuhës Baske dhe asaj Armene në 120 vitet e fundit. Autori është plotësisht i heshtur kur flitet mbi kërkimet dhe analizat rreth Baskëve dhe Armenëve dhe injoron plotësisht lidhjet më të dukshme gjuhësore ndërmjet këtyre dy gjuhëve. Kjo akoma më tepër provon se, Kurlanski nuk e dinte atë, që ai supozohej të dinte rreth ngjashmërive gjuhësore, gjë që çoi në mungesa thelbësore në punën e tij, për më tepër e çoi atë në konkluzione jo të plota. Nëqoftëse pranojmë që detyra e tij ishte të

* *Shënim B.P.*: Esteban de Garibay dhe Zamalloa lindi në Arrasate më 9 mars 1533, prindërit e tij ishin Esteban de Zamalloa dhe Garibay dhe Catalina de Sagurdia dhe Urrupain; vdiq 1599, Madrid, Spanjë.

⁸ *Shënim V. Setian*: Los XL Libros d'El Compendio Historial De las Chronicas y Universal Historia de Todos Los Reynos de Espana. Esteban de Garibay y Zamalloa, 1571

⁹ *Shënim V. Setian*: Aralar është gjithashtu emri i një partie politike Baske

përqëndrohej kryesisht në gjuhën, historinë dhe popullin Bask, atëhere lënia jashtë e ngjashmërive nuk është një pjesë e parëndësishme, që mund të shmanget pa komprometuar integritetin e materialit, që po trajtohet. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për historinë e lashtë.

Pavarësisht nëse lexuesi ka hasur ngjashmëri në gjuhët Baske-Armene, në legjendat apo mitologjinë e tyre, është thelbësore të ilustrohen ato këtu, pasi ka tregues të hershëm shkrimorë të gjuhës Armene dhe të Armenisë, që i lidh ato me Vendet Baske dhe ultësitrat Europiane:

*“Banorët e pjesës Spanjolle të Pireneve Franceze, siç kam thënë, janë njerëzit tanë (Baskët), dhe ka prova të bollshme për këtë. Në gjuhën tonë (Baske), Armenak qartazi nënkupton Armen. Dhe nëqoftëse ne i pyesim këta banorë prej nga janë, duke qenë ata vetë Baskë, ata do të përgjigjen “Armenak” në gjuhën Baske, që është njëlloj sikur të thuash “nga Armenia”, një vend prej nga ku ata e kanë origjinën.”*¹⁰ - Balthazar de Echave Orío (fundi i shekullit të 16^{te} – mesi i shekullit të 17^{te}), piktor Basko-Spanjoll, në vitin 1607 botoi një libër në gjuhën Baske. Është fakt, që Echave dhe Andres de Poza ndoqën Garibein.

“Me shumimin e Baskëve që erdhën nga Armenia dhe fushat e Sanaarit”

-Mbiemrat Baskë të Mbretërve, Lumenjve, Krahinave dhe Popullive. Në themel të forcës dhe hijeshisë së Gjuhës Kastiliane (1886)

“Ishulli Britanik është 800 milje i gjatë dhe 200 milje i gjerë. Dhe në këtë ishull ka pesë kombe: Anglezët, Uellsianët (ose British), Skocezët, Piktët dhe Latinët. Banorët e parë ishin Britonët, të cilët erdhën nga Armenia, dhe në fillim populluan pjesën jugore të Britanisë” – Kronikat Anglo-Saksone të shekullit të 9^{te}.

*“... me ardhjen e Armenëve në Spanjë unë jam i bindur, që kolonët tanë (banorët) të parë kanë qenë Armenët.”*¹¹

¹⁰ *Shënim V. Setian*: “Discursos de la antigüedad de la lengua cantabra Bascongada [1607], Ch. 8

¹¹ *Shënim V. Setian*: “Historia e qytetit të Valencias [1610]” – Gaspar Escolano, shkrimtar i shekullit të 17^{te}

Tabela 1a. 100 fjalë të ngjashme
Baskisht – Armenisht të shprehura në Spanjisht¹²

<u>Basque</u>	<u>Armenian</u>
<i>aina</i> “aquel, aquello, aquella”	<i>ain</i> (gen. ainu) “id”
<i>ainbeste</i> “tan, tanto (como aquel)”	<i>ainpes</i> (dial. ainpest) “(como aquel, de aquel modo)”
<i>aingana</i> “tanto como aquel”	<i>ainkhan</i> (dial. aingan) “tanto como aquel”
<i>(h)aize</i> “viento”	<i>ais</i> “viento”
<i>(h)an</i> “alli”	<i>hon</i> “alli”
<i>(h)andi</i> (var. anti) “de alli”	<i>andi</i> (var. anti) “de alli”
<i>(h)andiari</i> “grandeza”	<i>andranik</i> “mayor, superior”
<i>andena</i> “grupo, tropa”	<i>andei</i> “grupo, tropa de animales”
<i>(h)antz</i> “parecido, semejante”	<i>hantz</i> “parecido”
<i>hara</i> “he alli”	<i>ara</i> “he alli, mira”
<i>haran</i> “valle”	<i>aran</i> “valle”
<i>aradiza</i> “imperfeccion dejada por una enfermedad”	<i>arat</i> “imperfeccion defecto”
<i>arasta</i> “sentencia”	<i>arrats</i> “sentencia, proverbio”
<i>ardi</i> “oveja”	<i>arti</i> “oveja”
<i>argi</i> “luz”	<i>areg</i> (gen. aregi) “sol”
<i>arandia</i> “afan, anhelo”	<i>errand</i> (gen. errandi) “energia”

¹² *Shënim V. Setian*: Nga artikulli:

“Problemas de traducción Armenia de la literatura Vasca”

“Translation Problem of Armenian in Basque Language” – Sarkisian, 2002

Shënim B.P.: Probleme të përkthimit të gjuhës Armene në gjuhën Baske

<i>anu</i> “barranco”	<i>anu</i> “nachuelo”
<i>anueit</i> “esforrocino, sarmiento bastardo”	<i>anuoit</i> “trebol, alfalfa”
<i>artha</i> “cuidado, solicitud, diligencia”	<i>arthun</i> “diligente, despierto, proverbio”
<i>artza</i> “oso”	<i>arch</i> (dial. horch) “oso”
<i>astun</i> “pesado”	<i>hast</i> “grueso, pesado”
<i>bahi-tu</i> “apresar deterer”	<i>pahel</i> (dial. bah-el) “guardar”
<i>baimen</i> “permiso, consentimiento” acuerdo, consentimiento”	<i>paiman</i> (dial. baiman) “condicion, acuerdo, consentimiento”
<i>baizik</i> “sino, mas que; sino que”	<i>baitz</i> “pero, pues; sino que”
<i>bakarrik</i> “solamente”	<i>batzarrik</i> “excepcional, uniko”
<i>barzia-tu</i> “punzar”	<i>vars-el</i> “punsar, clavar”
<i>belu</i> “tarde”	<i>val</i> (gen. valu) “antiguamente, tardio”
<i>beluz-ko</i> “tardecito”	<i>valutz</i> “hace rato, hace mucho”
<i>berta</i> “cerca”	<i>merdz</i> “cerca” (cf. merdzavor “proximo”)
<i>bits</i> “espuma”	<i>bits</i> “huella sucia, mancha”
<i>buru</i> “cabeza”	<i>poir</i> (var. pur) “cabeza”
<i>dzart egin</i> “romperse una cosa”	<i>djard-el</i> “romper”
<i>eden</i> “caber”	<i>den-el</i> “poner, colocar”
<i>elge</i> “llano”	<i>yilk</i> “llano”
<i>elki</i> “salida”	<i>elkh</i> (gen. elkhi) “salida”
<i>erkin</i> “la que esta’ con dolores de parto”	<i>erken</i> “dolores de parto”

gaita “buen humor”

gari “trigo”

gasoil (garsoil) “calvo”

geiago “mas”

gendu “quitar”

gitxi “poco”

gitxiago “menos”

gohain-du “hastiararse”

goiti “residuo, sibra”

handies-te “exaltacion,
glorificacion”

haritz “roble”

haztatu “probar, confirmar”

horma “pared”

hurrundu (hurruntu) “alejarse”

hurtu “abundante en agua”

irur “tres”

jarauntsi “abundante”

jori “abundante, rico”

kain (gain) “tan, tanto”

karkoil “brusco, tosco, deforme, feo” *xarxul* “decadente, movedizo”
2. “decadente”

kartha-tu “romper, quebrar”

katra-tu “rompor, quebrantar”

kaitarr “vivaracho, gallardo”

gari “cebada”

khachal “calvo”

geragoin “mas alto”

khand-el “destruir”

khich (gen. khichi) “mas alto”

khechagoin “menos”

gohan-al “contentarse”

koit (gen. koiti) “monton, cumulo”

hands “rito solemne,
fiesta, exposition”

harrich “roble”

hastat-el “probar, confirmar”

orma (gen. ormo) “pared”

vrrend-el “espulsar, alejar”

hurthi “abundante en agua”

erir “tres veces”

jarang-el “heredar”

yoyr (gen. yoyri)

“gordo, espeso, hinchado”

khan “tan, tanto”

xarxul “decadente, movedizo”
2. “decadente”

xart-el “limar”

kotrat-el “desmenuzar,
hacer pedazos”

<i>keina</i> “amenaza”	<i>khen</i> “amenaza”
<i>korta</i> “sel, prado”	<i>kord</i> (gen. kordo) “tierra no labrada”
<i>matsarno</i> “vino”	<i>machar</i> “vino nuevo”
<i>mahu-tu</i> “morir, matar”	<i>mah</i> (gen. mahu) “muerte”
<i>matuts</i> “denso, espeso”	<i>matsutz-ik</i> “denso, espeso”
<i>murruntza</i> “mugido”	<i>merrunch</i> “mugido”
<i>murtzi</i> “puno”	<i>murtz</i> “puno”
<i>nagatu</i> “asquearse, detestar”	<i>naxat-el</i> “insultar, injuriar, ultrajar”
<i>oin</i> “pie”	(dial.) <i>oin</i> “pie”
<i>oker</i> “torcido”	<i>kerr</i> “torcido”
<i>ordo</i> “llano, llanura”	<i>hord</i> “llano”
<i>orroe</i> “bramido, rugido”	<i>ormotz</i> “bramido, rugido”
<i>otz</i> “frio”	<i>oits</i> “frio”
<i>otzago</i> “mas frio”	<i>oitsagoin</i> “mas frio”
<i>patari</i> “alimana, animal danino”	<i>patchar</i> (gen. patchari) “animal”
<i>pitxi</i> “adorno”	<i>pechin</i> “adorno”
<i>pixar</i> “poco”	<i>pitsarr</i> “poco, pequena cantidad”
<i>pizki-tu</i> “hacer hilachas”	<i>bezket-el</i> “destrozar, hacer pedazos”
<i>porro</i> “panza”	<i>phor</i> (gen. phoro) “vientre”
<i>putz</i> “soplo”	<i>phuch</i> “soplo”
<i>putzuka</i> “abotagado, inflado”	(dial.) <i>phechuk</i> “hinchado”
<i>sakhi</i> “herida de instrumento cortante”	<i>tsak</i> (gen. tsaki) “hueco, herida”

sein “nino”

sasta-tu “pinchar, punzar”

³⁷ *Shënim V. Setian*: Profesor P. Jensen, PhD i Marburgut, ka bërë një punë të madhe dhe kërkime të shumta rreth mbishkrimeve Hittite në periudhën, që i takon rreth një shekulli më parë.

Ne mund të themi me siguri se Mbretëria Araratiane (Urtu) ka qenë vazhduese direkte e Mbretërisë Mittani dhe në të njëjtën afërsi gjeografike. Tekstet e vjetra Urtiane dhe fjalori Urtian zbuluan që 70% e rrënjëve të fjalëve janë fjalë Armene. Ne mund ta pranojmë mendimin se gramatika e çdo gjuhe ndryshon me kalimin e kohës, por shqiptimi ndryshon shumë më pak (shumë më ngadalë), duke lënë në këtë mënyrë shqiptimin Armen dhe atë Bianian (Urtu) të padëmtuar dhe të njëjtë, ashtu siç janë. Shembull për këtë ne kemi fjalët: Ur. - asi (Arm. ais - ky, kjo), Ur. - ati (Arm. aid - ky, kjo), Ur. - ani (Arm. ajn - ai ajo), Ur. - asika (Arm. asika - ky, kjo), atika (Arm. atika - ai, ajo), anika (Arm. anika - ai, ajo). Aivazian (2011) argumentoi se gjuha Armene dhe ajo Urtiane janë e njëjta, dhe kështu duhet të jetë nga pikëpamja historike, gjenetike dhe antropologjike. Ndokush me siguri mund të argumentojë rastin, që si Gjuha Urtiane ashtu edhe ajo Armene janë e njëjta, dhe ne këtu vetëm po analizojmë të parën me përmbajtjen dhe strukturën aktuale të kësaj të fundit. Nëqoftëse kufizimet e gjuhës Semitike nuk do të lejonin fjalën Ararat të shqiptohej me zanoret e duhura (përkatëse), duke e lënë atë të shqiptohej Urtu (RRT), nuk do të kishte kuptim në vazhdimin e përdorimit të fjalës Urtu, kur ne kemi zanore, në ndryshim nga mungesa e zanoreve në gjuhën Akkadiane apo Assiriane, për ta shqiptuar atë Ararat. Aivazian (2015) gjeti se një krahasim i gjuhëve Bianian (Urtian)³⁸ dhe Armene zbulonte se:

- a) pjesa më e madhe e fondit të fjalëve (fjalorit) Bianian, që ka arritur deri tek ne dhe është i kuptueshëm, ka të ngjashmit e vet në gjuhën Armene;
- b) shumica e këtyre fjalëve të përbashkëta (rrënjëve) janë të Armenishtes vendase duke qenë në origjinë Indi-Europiane në vlera sasiore dhe gjuhësore;
- c) përbërësi Armen përfaqëson bazën e gjuhës Bianian dhe nuk mund të jetë rezultat i huazimeve apo ndërveprimeve;
- d) ekziston një shtrat i sigurtë i gjuhës Hurriane si në fjalorin Bianian ashtu edhe në disa elemente gramatikore, të cilat,

TABELA 8. Paralelizmat e fjalëve
Urartiano - Armene; (Aivazian, 2011)

PIE.	Urartian	Armenian
*serg'	- erši- [erši-]	- z-erc.
*eg'	- ieše [yes]	- es.
*g'ṛ-so	- šare [šaṛ]	- caṛ, -oy.
*ṛg'ipi-jo	- aršibe [aršiw]	- arcowi (-ciw).
*g'en-os	- šinu- [šino-]	- cin -i. old *cino.
*phəlg'-niā	- paršane [paɽʃan]	- *p'ayɽcan > p'aycaɽn, -an.
*g'huɽn-ji	- zani- [jayni-]	- jayn, -i.
*g'hō	- z- [z-/j-]	- z- or j-.
*bhṛg'h-	- barzu/i- [barju/i-]	- barj. -ow/i.
*g'hu-ū (?)	- suui- [juw-]	- *jowg- (?) > jg-em.
*ə(n)k'	- (h)aš- [(h)as-]	- h-as-an-em.
*k'er	- šer- [seṛ]	- seṛ, -i.
*k'er-no	- šere [seṛ]	- seṛ-n.
*k'o-ro	- šuri/e [sur(i)]	- sowr, -oy.
*k'o, *k'e	- šu-, ša- [i=so-, i=sa-]	- so-yn, sa-, etc.
*(e)g ^u a-	- ka-	- ka-m.
*g ^u hono	- gunu- [juño-]	- jown-ŷ, jn-em.
*k ^u -ro	- ule [or]	- or, -oy, owr-iš (?).
*k ^u ur	- ure [ur]	- owr.
*k ^u i	- hi=ne [hi=n]	- (h)i-n-č', z-i,
*jēk ^u ṛ-t	- zielde [jierd]	- *jiard > leard.

PIE.	Urartian	Armenian
*bhṛg'h-	- barzu/i- [barju/i-]	- barj, -ow/i.
*bher	- (-)ber- [(-)ber-]	- ber-em.
*bhā	- ba=u- [ba=w-]	- ba-n, ba-y.
*obhel	- abeli- [aweli-]	- aweli.
*phoro	- pulu- [pōro-]	- p'or, -oy.
*phəlg'-niā	- paršane [paɽʃan]	- *p'ayɽcan > p'aycaɽn, -an
*alph	- erb- [eɽp-] (?)	- aɽp'-owc'-an-em (?).
*sub	- up- [up-]	- (h)owp-.
*epi	- eue, ewe [ew]	- ew.
*ṛg'ipi-jo	- aršibe [aršiw]	- arcowi (-ciw), etc.

sidoqoftë, përputhen si nga ana sasiore ashtu edhe nga ajo cilësore me gjuhën Armene.

Sipas Mordtmannit (1877), Armenishtja ishte e nevojshme për të dëshifruar mbishkrimet kuneiforme Urartiane. Lista përbledhëse e Aivazianit përfshiu fjalët dhe rrënjët e ngjashme Armeno – Urartiane të rregjistruara këto nga studjues të ndryshëm. Aivaziani (2011) gjeti se, ndashtesat nominale (nominal affixes) dhe prapashtesat foljore (verbal suffixes) të hasura në mbishkrimet Urartiane kanë paralelet (të ngjashmet) e tyre në gjuhën Armene. Më tej, Aivaziani (2015) pohon se llogaritjet tregojnë se 61% e rrënjëve dhe 85-90% e ndajshesave derivacionale të fjalorit të kuptueshëm Bianian (Urartian) janë të njëjta me ato të gjuhës Armene.

Shumë prej atyre që kanë synuar të analizojnë gjuhën Araratiane (d.m.th., Urartean, Urartian, Biainian) pa ndihmën e gjuhës Armene, në një farë mënyre nuk e kanë pasur parasysht këtë kujtesë (njoftim). Lidhur me faktin e lënies pas dore të të dhënave shumë të rëndësishme, ne këtë po e provojmë në fomën e saj më të pakëndshme. Nëqoftëse Kassiani do të kishte qenë në gjendje të gjente ngjashmëri fonetike ndërmjet gjuhës Sumeriane dhe të ashtuquajturës Hurro-Urartean duke përdorur teorinë e probabilitetit, ne do të kishim mundur të arrinim rezultate astronomike, nëqoftëse do të ishte aplikuar një metodë statistikore për paralelizmat (fjalët e ngjashme) Basko-Armene dhe paralelizmat Armeno-Urartiane.

Tani, materiali kërkimor i Kassianit është i lidhur shumë ngushtë me kërkimet e Xhon D. Bengston (John D. Bengston), i cili, vetë, është një gjuhëtar historik dhe antropologjist si edhe botues i revistës “*Gjuha Mëme*”. Bengstoni ka botuar artikuj të ndryshëm me analiza të gjuhës Baske, punë të cilën shpesh ai e zhvilloi në skuadër me Kassianin në një numër rastesh (Bengston, 2013; Kassian, 2013) duke kritikuar përpjekjet e Gianfranco Fornit³⁹ (Forni, 2013) për të lidhur gjuhën

³⁹ *Shënim V. Setian*: Gianfranco Forni është një gjuhëtar historik i specializuar në klasifikimin gjenetik të gjuhëve

Baske me pemën e gjuhëve Indo-Europiane. Si përfundim, Kassiani dhe Bengstoni kanë mangësi të shumta të dhënash të rëndësishme në materialin e tyre kërkimor, ndërkohë që kritikojnë Fornin për dështimin e tij “në vërtetimin e teorisë Basko-IndoEuropiane” dhe që metodologjia e gjuhësisë historike akoma nuk ka ecur përpara sa duhet dhe “teori të tilla amatoreske janë një fushë e mirë vërtetimi, që na ndihmon neve të përmirësojmë metodat tona” (Kassian, fq. 197). Bengstoni (2013) është më i larmishëm dhe më komunikues me fjalët e tij, ndërkohë që argumentonte për të, të qenët “si një njeri, i cili kishte hetuar shumë seriozisht klasifikimin gjenetik të gjuhës Baske për afër dy dekada e gjysëm të shkuara Është qartësisht e dukshme për mua që hipotezat e Fornit (Lidhja Basko-Indoeuropiane) nuk ja kanë arritur ... “ të paraqesin një propozim klasifikues, i cili të na jepte shpjegimin më të mirë për afërsinë gjenetike të Baskëve. (Fq. 6)

Forni (2013) vazhdoi punën, duke ju përgjigjur ndërkohë kritikave të tij dhe publikoi një fjalor etimologjik me marrjen në konsideratë të gjuhës Baske si një gjuhë Indo-Europiane (Forni, 2014). Ai nuk është i vetëm në përpjekjet për të lidhur gjuhën Baske me pemën e gjuhëve Indo-Europiane. Fournet (2012), duke shfrytëzuar listën me 100 fjalë të Swadeshit, gjeti 30 elemente, të cilat ishin bazuar në rrënjë, që kishin të përbashkëta ndërmjet Baskishtes dhe Proto-Indo-Europianes (PIE). Tre konkluzionet e mundshme, që ai u përpoq të nxirrte nga vërtetimet e tij, ishin:

- 1** Korrespondencat ishin në përputhje me përkimet (koincidenat) rastësore.
- 2** Gjuha Baske ka në përmbajtje një sasi domethënëse fjalësh Indo-Europiane, të cilat kanë hyrë në gjuhë në një kohë shumë të hershme.
- 3** Gjuha Baske është shumë më e afërt me gjuhën Indo-Europiane, se sa ka pasë qenë menduar më parë.

Konkluzionet e tij ishin, gjithashtu, kritike ndaj mbrojtjes së tepruar të Bengstonit dhe Traskut mbi gjuhën Baske dhe përpjekjeve të tyre

të çuditshme për ta mbajtur atë sterile nga ndonjë bashkësi gjuhësh Indo-Europiane, duke u shfaqur kështu, se ata do të kishin preferuar, që ajo të ishte e palidhur me familjen Indo-Europiane. Nga rezultatet e vrojtimeve të tij Fourneti konkludoi, se do të ishte më mirë, që gjuha Baske të konsiderohej e lidhur me fqinjët e saj të sotëm, pasi ajo zotëron tipare morfologjike të ngjashme me PIE, dhe prandaj nuk mund të pranohet, që gjuha Baske nuk ka lidhje me PIE. Forni dhe Fournet janë të ngjashëm në qasjen e tyre në shqyrtimin e gjuhës Baske në kuadrin e gjuhës Indo-Europiane. Sidoqoftë, ata ndryshojnë në një pikë takimi tangente kritike: Forni përfshiu fjalët Armene për të treguar afërsinë e gjuhës Baske me gjuhët Indo-Europiane. Fourneti nuk e përmend këtë, edhe pse fjalët e marra në shqyrtim kanë fjalë Armene të fshehura brenda shembujve me fjalë PIE/Baske, siç është p.sh. fjala Baske “*errer*” – *me djeg* dhe ajo Armene *ayr/ayrel* – (*այրել*) – *me djeg*, e cila në rastin e Forni është përmendur si e ngjashme (paralelizëm) ndërmjet Armenishtes dhe Baskishtes. Koch (2013), gjithashtu, shqyrtoi shkrimet me rezultatet e studimeve kërkimore të Forni (2013).

Ndonëse ai nuk e pranon pohimin e Forni që gjuha Baske është një gjuhë Indo-Europiane, ai pranon të marrë në konsideratë, që mund të ketë një influencë Indo-Europiane, nga ndonjë shtresë para-Romane, në gjuhën Baske. Është interesant të vihet në dukje fakti që, metoda rikonstruktive (rindërtuese) dhe punimet e Martinez-Areta kanë zbuluar, që korrespondencat zanore për të gjitha bashkëtingëlloret dhe zanoret në një masë të madhe të rrënjëve, trungjeve dhe fjalëve, që përbëjnë fjalorin bazik, tregojnë që, Proto-Baskishtja dhe Proto-Indo-Europianishtja kanë lidhje me njera tjetrën. Më hollësisht, jo sugjerimi që PB (Proto-Baske) rrjedh nga PIE, por hipoteza që dy gjuhë të lashta rrjedhin nga e njëjta gjuhë, një gjuhë mëmë akoma më e lashtë (Blevins, Përparime në Rikonstruksionin e gjuhës Proto-Baske dhe hipotezat Proto-Indo-Europiane-Euskara; Blevins, 2014). Xhon T. Koch, nga Universiteti i Uellsit, Qendra për Studime Uellsiane dhe Kelte të Avancuara (Aberystwyth), ekspert në historinë e gjuhëve Keltike dhe sfondin e tyre arkeologjik, e gjeti të vështirë të pranonte,

që Forni konsideronte, që gjuha Italo-Kelte të ishte më afër me çështjet Basko-PIE se çdo gjuhë tjetër IE. Shkrimi “Historia e gjuhës Baske” e Manfred Owstrowskit, krahas marrjes në konsideratë të gjuhës Baske si e vetmja gjuhë e gjallë jo-Indo-Europiane në Europën Perëndimore, përmend edhe punimet e Trask dhe Michelena pa përmendur ndonjë punim të Sarkisianit, edhe pse, ai bën krahasime fjalësh të gjuhës Baske me ato Akuitane, me ato Indo-Europiane në përgjithësi, dhe Kelte, Iberiane dhe Kaukaziane, për të përcaktuar lidhje ndërmjet tyre. Për shembull, ai shkruan dhe unë në citoj:

“Ka disa raste ku duket sikur fjalët Baske dhe Kelte të jenë të njëjta, po ku ligjet akustike nuk e pranojnë një lidhje direkte. Fjala Baske “hartz” ... (*...dhe vazhdon më poshtë me analizën e saj ... Shënim B.P.*)

Koch, sidoqoftë, pranon që paralelizmat Basko – Kelte mund të mos jenë të papranueshme, nëqoftëse merren në konsideratë zhvillimet semantike përgjatë kohës. Si Koch ashtu edhe Forni janë dukshëm të pavëmendshëm për atë që mund t’i surprizojë ata po të kishin parasysh numrin e konsiderueshëm të korrespondencave fonetike dhe semantike ndërmjet gjuhës Baske dhe Armene. Një nga arësyet kryesore që më shtyn të pohoj këtë gjë, është për faktin, që të gjithë këta kërkues, të cilët ose e konsiderojnë gjuhën Baske si një gjuhë të izoluar, ose që ka një lidhje të ngushtë me një tjetër gjuhë joIE (jo-Indo-Europiane), ose që ka lidhje me gjuhët IE, nuk kanë as idenë më të vogël se idetë dhe kërkimet e tyre mund të përmbysen me 180 gradë, nëqoftëse ata do t’i ekspozoheshin sasisë së madhe të korrespondimeve ndërmjet fjalëve të gjuhës Armene dhe asaj Baske, gjë që do të errësonte sasinë relativisht të vogël të korrespondimeve të gjetura ndërmjet fjalëve të gjuhës Baske dhe gjuhëve të tjera. Në lidhje me korrespondencat gjuhësore, shkrimeve të ndryshme kërkimore të Xhon D. Bengstonit do të duhej t’u kushtohet pak vëmendje këtu, pasi ai shpenzoi shumë vjet duke analizuar gjuhën Baske, duke e konsideruar atë me origjinë Dene-Kaukaziane. Rastësisht, ishte identifikimi i ngjashmërive i Garibeit ndërmjet toponimeve në vendet Armene dhe Baske, që influencoi në hipotezën Basko-Kaukaziane, të cilën kërkuesit e

shekullit të 20^{të}, përfshirë edhe Bengstonin, në një farë mënyre e devijuan nga targeti kryesor gjeografik, duke hipur më në veri të Kaukazit dhe duke futur edhe gjuhë të tjera nga Amerika e Veriut. Të lidhësh gjuhën Baske me atë Dene-Kaukaziane do të thotë të humbësh pikën e orientimit. Le të vazhdojmë.

Lidhjet Dene-Kaukaziane me gjuhën Baske janë të dukshme në shkrimet akademike të ndryshme të Bengstonit (Bengston, 2003; Bengston, 2008a; Bengston, 2008b; Bengston, 2008c; Bengston, 2008d; Bengston, 2009; Bengston, 2011). Por a janë vallë ato, dukuri që tregojnë lidhje? Përgjigja është negative (jo) për disa arsye. Bengstoni anashkaloi lidhjet tashmë të pranuar me gjuhën Armene dhe lidhja Dene-Kaukaziano-Baske e trajtuar prej tij është e paplotë sepse, ndoshta Bengstoni nuk dinte gjë për lidhjen e vendosur tashmë ndërmjet gjuhës Baske dhe Armene, e cila ishte mjaftueshmërisht e lexueshme për rishikimin dhe marrjen në konsideratë nga ana e tij. Ai nuk e njihte gjuhën Armene, me qëllim që të mund ta krahasonte gjuhën Baske me të, ose ai anashkaloi lidhjen Basko-Armene për arsyen e vetme se ajo nuk i përshtatej analizës së tij krahasuese. Pretendimi i tij për lidhjen e -Dene-Kaukazan me gjuhën Baske, duke marrë në konsideratë faktin, që ai përdorte leksikon dhe fonologjinë si komponente të shqyrtimeve të tij gjuhësore historike, në përgjithësi nuk reflekton një lidhje racionale. Ai argumentoi se analizat e tij (Bengston, 2011) e udhëhoqën atë të arrinte në përfundimin që gjuha Baske ka “një strukturë të thellë gjenetike leksikore dhe gramatikore”, e cila reflekton një origjinë Dene-Kaukaziane, ndërsa kontaktet kulturore të Baskishtes përfshinin gjuhët Semite, Egjiptiane, Kelte, Gjermane, Latinishten e hershme dhe format e vona të gjuhës Latine me variantet e ndryshme të gjuhës Romane. Ne nuk duam të ulim karakterin Kaukazan të foljeve Baske, që tashmë është shtjelluar nga Robert Ellis më 1886. Përsa i përket ndikimit të Dene-Kaukazan në gjuhën Baske, Bengstoni (2009) pohoi se paraardhësit e Baskëve ruajtën ekonominë e tyre gjatë dhe grumbulluese për shekuj derisa, duke ju nënshtuar përparimeve Neolitike rreth viteve 5200 - 4600 BCE, përshtatën

përfundimisht edhe gjuhën e tyre të re Dene-Kaukaziane krahas me zhvillime të tjera kulturore. Më tej, ai konkludoi se tiparet linguistike të fjalëve të vjetra Neolitike në gjuhën Baske tregojnë se, ato kanë të njëjtën origjinë si edhe shtresat më bazike (fondamentale, themelore) të fjalorit, duke treguar të gjitha, që janë Dene-Kaukaziane. Nga njera anë, Bengstoni tërhoqi opinionin e Traskut (1997, 2001) për Baskishten si një gjuhë gjenetiki dhe izoluar dhe pohimin e tij se “as grimca më e vogël e dukurisë se ajo ishte e lidhur me ndonjë gjuhë tjetër të gjallë” (Trask, 1997, Fq. 35). Nga ana tjetër, Bengstoni është duke e konfuzuar lexuesin duke e ndërlikuar orientimin e tij ndaj popujve, grupeve etnike, historisë dhe gjeografisë së lashtë. Për shembull, ai pohon se, “kontaktet me Semitët janë të mundshme, nëqoftëse linguistët i trajtojnë Baskët si të prejardhur nga Anadoli”. Ai është gjithashtu në favor të trajtimit të idesë, që ajo është një kulturë Kardale (Cardium Culture), përsëri me origjinë nga “Anatolia”, që kishte njohuri rreth bimëve dhe kafshëve shtëpiake, tregtisë së xhamit vullkanik në distanca të gjata dhe materialeve të tjera me natyrë gurore. Nëqoftëse ai ndoqi perspektivën e Baskistit (studjues i Baskëve) Rene Lafon, të cilin ai e ka përmendur, do të dilte e qartë që “popujt e vendeve Baske dhe Akuitanisë adoptuan një gjuhë të huaj nga një popullsi imigrante, e cila sollti një kulturë teknologjike më superiore” (Fq. 165)⁴¹. Rene Lafon dhe Antonio Tovar luajtën një rol të konsiderueshëm në përparimin në lidhje me shqyrtimin e afërsive Basko-Kaukaziane duke ndikuar tek të tjerët, që qëndronin jashtë kësaj linje, ndonëse R. L. Trask dhe Luis Michelena e refuzuan këtë linjë.

Nëqoftëse do të viheshim të ndiqnim metodat personale të Bengstonit të analizës krahasuese, duke përdorur vlerësimet e balancuara gjatë vlerësimit të fjalorit dhe të provave fonologjike si edhe emigrimet e lashta historike nëpër Europë, do të ishte e pamundur

⁴¹ *Shënim V. Setian*: “La langue basque n’est pas une langue indigene, autochtone; c’est une langue d’origine étrangère, d’adoption d’une civilisation supérieure par certains cotes a la leur propre ...” (Lafon 1949, p. 206)

të shmangej lidhja e gjuhës Armene nga lidhja direkte me gjuhën Baske. Madje, ne akoma nuk po përmendim ndryshimet semantike apo kulturele. Në një shënim të shkurtër anësor, Dene-Kaukazian ka gjithashtu edhe gjuhën Navaxho (Navajo) dhe të dyja këto, Armenishtja dhe Navaxho, kanë të njëjtën fjalë për “zog”: Navaxho – “*tsidi*”; Arm. “*tsid*” ose “*tsidik*”. Përveç kësaj, nëqoftëse Bengstoni do të kishte ditur se në gjuhën Armene, “*ujit*” i thonë “*xhur, çur*”, ai do ta kishte përmendur atë kur krahason fjalën Baske “*ur*” ose “*hur*”, që përdoret për ujin, me fjalën Lezgiane “*hyl*”, ose të krahasonte fjalën Baske “*gari*” për “*grurë*” me fjalën Armene “*gari*”, “*barlei, barli*”, në vend që të (Bengston, 2009) krahasonte fjalën Baske “*gari*” me Tindishten “*q’eru*” ose Lezgianen “*q:yl*” për “*grurë*”. Nëqoftëse do të kishim rastin të krahasonim grupin Basko-Armenisht dhe Basko-Dene-Kaukazian të Bengstonit, duke u përqëndruar në shqyrtimin e komponenteve, siç janë kontaktet fonologjike, semantike dhe kulturore, grupi i parë do të kishte qenë më i përshtatshëm. Por nëqoftëse ne do të përqëndroheshim në hamendje dhe elemente të paracaktuara, të cilat mund të rezultonin të gabuara, por shumë vonë për t’u tërhequr, atëhere kërkuesi do të shndërrohej në një kalë, të cilit i kanë vënë kufizues shikimi. Kështu, përdorimi i rindërtimit të Proto-Pre-Baskishtes nga ana e Bengstonit është po aq problematik sa edhe ai i Traskut, të cilin ai vetë e kritikoi, pasi që të dy ata janë në anë të kundërta të arritjes së zgjidhjes së problemit. Tambovcevi (Tambovtsev, 2003) theksoi, se një qënie humane është në gjendje të perceptojë nëse një gjuhë e caktuar mund të tingëllojë e ngjashme me gjuhën e tij amtare, pa arritur të kuptojë kuptimin (fq. 775)⁴², dhe kjo është një perspektivë që haset rrallë të përdoret.

⁴² *Shënim V. Setian*: Ai përdori matjen e distancave fotostatistikore për të përcaktuar se sa e ngjashme ishte gjuha Baske me gjuhët e tjera, duke u bazuar në frekuencën e shfaqjes së tipareve të bashkëtingëllorëve tipike. Nuk duket të jetë një rrugë e arësyeshme për të përfituar rezultate të përshtatshme atje ku ato mund të krijonin hutim (çoroditje) të madh duke u ngatërruar kollaj me të 119 gjuhët botërore, që bëjnë pjesë në familjet Indo-Europiane, Turkike, Finno-Ugarik, Tungus-Mançurian, Uralik, Ural-Altai, Paleo-Aziatik, Sino-Tiberian, dhe Austro-Aziatik.

Shpartallimi i gjuhës Dene-Kaukaziane nuk mbaron këtu. Ajo u trazua më tej prej Swadeshit në momentin, që ai përfshiu gjuhën Baske, Kaukaziane, Ural-Altaik, Dravidian, Tibeto-Burman, Kineze, Austronezian, Japoneze, Çuki (Chuckhi) (Siberia), Eskimo-Aleut, Uakash (Wakash), Na-Dene dhe Sumerian nën të njëjtën ombrellë (shih: “Tras la Huella linguistica de la prehistoria” – “After the linguistic imprint of prehistory” – “Pas gjurmës gjuhësore të parahistorisë”, Swadesh, 1987). Ruhlen (1994) u pajtua me tezën e Xhon Bengstonit, që gjuha Baske dhe ajo Sumeriane⁴³ i përkisnin familjes Dene-Kaukaziane.

Sidoqoftë, Kristal (Crystal, 1992) ka argumentuar se, përpjekjet për të treguar lidhje të gjuhës Baske me gjuhët Kaukaziane dhe Afrikano Veriore ose ato Iberike nuk kanë qenë bindëse. Renfrew (2000) e vuri në dukje këtë çështje, duke pohuar se lidhja e gjuhës Baske dhe Sumeriane me ato të mikrofamiljes Sino-Kaukaziane, me të cilën do të duhej të ishte e lidhur edhe gjuha Da-Nene e Amerikës Veriore, ishte një hipotezë e parakohshme (e nxituar) sepse pjesa më e madhe e punës së Starostinit, mbi të cilën ishte e bazuar kjo hipotezë, ishte e bazuar gjerësisht (dhe kryesisht) në gjuhën Ruse dhe nuk kishte ndjekur rrugën e evolucionit të duhur dhe sistematik.

Efektet negative të punës së Swadeshit mbi gjuhësinë krahasimore⁴⁴ ishin të ngjashme me efektet negative të punimeve të Igor Diakonoffit (1915-1999)⁴⁵ mbi shqyrtimet e lashta historike, veçanërisht konkluzionet e gabuara që erdhën prej botimit (1976) të tij dhe Sergei A. Starostin, “*Gjuha Hurro-Urartiane si një gjuhë e Kaukazit Lindor*”, botim, që qarkulloi dhe u riciklua në kumtime

⁴³ *Shënim V. Setian*: Merritt Ruhlen ka përdorur më tepër fjalën “Shumerian” se sa “Sumerian” në këtë punim.

⁴⁴ *Shënim V. Setian*: Glotokronologjia, pjesë e së cilës ishte edhe Swadeshi, për një kohë të gjatë ka qenë jashtë preferencave, pasi ajo kërkonte nga gjuhëtarët, që të pranonin, që fjalët e ndryshojnë formën e tyre në mënyrë të vazhdueshme (në mënyrë të qëndrueshme) përgjatë kohës, gjë për të cilën ata e dinin që nuk është e saktë. Kështu që, përdorimi i listës së fjalëve të Swadeshit është problematik.

⁴⁵ *Shënim V. Setian*: Nganjëherë shqiptohet D’iakonov.

dhe gazeta të shumta shkencore⁴⁶, i cili madje u bë pjesë e shqyrtimeve të gjuhës Baske nga ana e Bengstonit.

Sidoqoftë, këto konkluzione kanë një vijë argjendi (të shndritshme): Ato na furnizojnë neve me lidhjet, që ekzistojnë ndërmjet gjuhëve Urartiano-Armeno-Baske, madje me ose pa ndërgjegjen e autorëve apo qëllimin vullnetar të tyre. Murtaçali S. Gaxhev (Murtaçali S. Gadjiev)⁴⁷ gjykoi që Diakonoff dhe Starostin shkruajtën me më shumë “kujdes” rreth origjinës së përbashkët ndërmjet gjuhëve Hurro-Urartiane dhe atyre Kaukaziane lindore (Fq. 118), duke qenë më të kujdesshëm në bërjen e pohimeve përfundimtare (përcaktuese). Në papajtueshmëri me ta, unë i shoh përfundimet e tyre si të kujdesshme për të qenë tepër të dukshme (jashtë çdo dyshimi) në fushën akademike, ndërkohë që përmbajnë aluzione, të cilat i çorientojnë kërkuesit.

Kështu, ngatërresa me fjalët dhe krijimi i konfuzionit për shkak të pasigurive të tyre duket të jenë thelbi i strategjisë letrare brenda fushës akademike. P.sh., Diakonoff dhe Starostin konsideruan që Armenët e sotëm janë një amalgamë e grupeve Indo-Europiane me ato Hurriane dhe Urartiane⁴⁸ ndërkohë që pranojnë se Hurrianët flasin një gjuhë *ergative-agglutinative*, të quajtur konvencionalisht Hurriane, e cila nuk ka lidhje me gjuhët Semitike apo Indo-Europiane, duke e bërë gjuhën Urartiane të Epokës së Hekurit të jetë ngushtësisht e lidhur me gjuhën Hurriane ose një pasardhëse direkte të saj. Pas kësaj, ne kemi Starostin dhe Ivanovin, të cilët deklarojnë, që gjuha Hurriane dhe Hatti janë të lidhura me gjuhët e Kaukazit Verior. Madje, edhe llafollogjia e përdorur nga Diakonoff zbuloi zhgënjimin (dështimin) e tij dhe qëllimin për të vënë në lëvizje si audiencën ashtu edhe kërkuesit, të cilët gjetën

⁴⁶ *Shënim V. Setian*: Shih Nikolayev, S., dhe S. Starostin. 1994, North Caucasian Etymological Dictionary. Moscow; Asterisk Press.

⁴⁷ *Shënim V. Setian*: Në “Selective Remembrances: Archaeology in the Construction, Commemoration, and Consecration of National Pasts”. (Kohl, Kozeiksy, and Ben-Yehuda, eds.). 2008

⁴⁸ *Shënim V. Setian*: Në histori nuk ka pasur kurrë ndonjë grup etnik të quajtur “Urartianët”.

dukuri, që flisnin për të kundërtën e tezave të tij. P.sh., Diakonoff pasi pa që, hipotezat Indo-Europiane të Gamkrelidzes dhe Ivanovit (Shih, p. sh., Gamkrelidze & Ivanov, 1990) i nxirrnin Armenët banorë vendas direktë dhe autoktonë të vendndodhjes së tyre aktuale, shkroi: “Kjo tezë do të marrë dhe tashmë i ka marrë brohoritjet e publikut” (Diakonoff, 1985, fq. 156-157).

Kjo formë të shprehuri tashmë do të thotë shumë. Sidoqoftë, kërkimi i tyre, pavarësisht shmangieve (lënies jashtë trajtimit), na pajis neve me material shtesë për të ngritur pyetjet: A duhet neve t'i ndërpresim (apo t'i mbajmë pezull, t'i mbajmë varur) analizat tona mbi paralelizmat (ngjashmëritë) e dukshme gjuhësore ndërmjet dy gjuhëve për shkakun e vetëm se njera ose tjetra prej tyre nuk i përkasin të njëjtës familje gjuhësore? Nëse ne mbështetemi vetëm në kërkimin e kësaj lidhjeje “gjenetike” dhe heqim dorë nga çfarë mund të na ndriçojë më tej në studimin e paralelizmave (ngjashmërive) gjuhësore ndërmjet gjuhëve, atëherë ne jemi në një gjendje akoma më shqetësuese sesa u mendua fillimisht. Watkins (1969) mbron një perspektivë më interesante, me të cilën unë bie dakord:

“Por duhet të theksohet se trashëgimia kulturore, ndërkohë që ajo synon të përputhet me vazhdimësinë kulturore, nuk nënkupton prejardhje gjenetike apo biologjike. Gjuhëtarët e përdorin frazën “e lidhur gjenetikisht”, thjesht për t’ju referuar gjuhëve, që rrjedhin nga një paraardhës i përbashkët. Gjuha e transmetuar nëpërmjet pushtimit, asimilimit, migrimit, ose ndonjë lloj tjetër lëvizje populjsh (etnish) është një proces kompleks dhe enigmatik, analiza e të cilit nuk është pjesë e këtij diskutimi – përtej propozimit të përgjithshëm, sipas të cilit në rastin Indo-European nuk mund ose nuk duhet të nxirren konkluzione gjenetike.”

Skeptikët e paralelizmave Basko-Armene duket se sugjerojnë, në disa raste edhe në mënyrë përfundimtare, se për sa kohë nuk gjendet ndonjë lidhje gjenetike ndërmjet tyre, nuk ka përse të ndërmerren studime të mëtejshme në këtë drejtim. Për ta komplikuar edhe më tej këtë prerogativë (paragjykim), ne jemi të detyruar të

analizojmë paralelizmat gjuhësore ndërmjet gjuhëve IE dhe joIE dhe madje, duke ju shtuar këtyre edhe komplikime të tjera, ne duhet të pranojmë konkluzionet e tyre si autoritative, sipas të cilave përcaktohet se cilat gjuhë duhet të konsiderohen IE dhe cilat jo. Të kënaqur, ne duhet të tregojmë kujdes kur bëhet fjalë për gjuhësinë krahasuese, si p.sh. konsiderata që, ngjashmëritë gjuhësore ndërmjet gjuhëve “të palidhura” jo domosdoshmërisht nënkuptojnë që ato janë të lidhura, siç janë p.sh. një apo dy fjalë Japoneze, të cilat janë fonetiki dhe semantiki të ngjashme me ato të një gjuhe në Amerikën e Jugut, ose një fjalë Greke, e cila mund të jetë e ngjashme me një fjalë, që përdoret në Klamath të Oregonit. Ngjashmëritë universale, gjithashtu, nuk mund të jenë tregues të lidhjeve gjuhësore, siç është p.sh. fjala “mama” (Watkins, 1969), ndonëse unë nuk pajtohem me këtë shembull të veçantë. Sidoqoftë, nëqoftëse ne ndjekim një rrugë matematikore dhe më racionale në lidhje me gjuhësinë krahasuese, kufizuesit tanë të rreptë kanë hapësirë për t’u zgjeruar. Le të rishohim një konsideratë, e cila nuk ka për detyrë të trajtojë dy gjuhë të palidhura si të lidhura, edhe nëqoftëse një, dy apo tre fjalë mund të gjenden ndërmjet tyre, të cilat janë fonetiki dhe semantiki të ngjashme. Nëqoftëse neve na duhet të mënjanohet ngjashmëritë fonetike dhe semantike ndërmjet dy gjuhëve të palidhura në kuptimin e përgjithshëm, atëherë si duhet të veprojme për ngjashmëritë ndërmjet gjuhës Armene dhe asaj Rapa Nui nga Polinezia?

TABELA 9. Ngjashmëritë Polineziano-Armene⁴⁹

<u>Dialektet Polineziane (RAPA NUI)</u>	<u>Armenisht</u>
<i>haite</i> - “i njohur ose i famshëm”	<i>haitni</i> - “i famshëm”

⁴⁹ *Shënim V. Setian*: Leila Stepanian, profesore e gjuhës Armene në Armeni, ka gjetur shumë paralelizma të shtresave gjuhësore Armene me gjuhët Polineziane.

<i>hina</i> - “i vjetër, gri ose i bardhë”	<i>hin</i> - “i vjetër”
<i>hini-hini</i> - “shumë i vjetër”	<i>hin</i> - “i vjetër”
<i>hoor</i> - “zjarr”	<i>hoor</i> - “zjarr”
<i>tsitsik</i> - “sisë, gj, gjoks”	<i>tsitsik</i> - “sisë, gj, gjoks” (në zhargon)
<i>katakata</i> - “luaj, bëj shaka”	<i>katak</i> - “shaka”
<i>tari</i> - “marr prej”	<i>tar</i> - “marr”
<i>taruriruri</i> - “tund, përkund”	<i>oror(el)</i> - “tund, përkund; nanuris, vë në gjumë”
<i>karikari</i> - “shkëmb, shkrep”	<i>kar(karap)</i> - “gur; shkëmb, shkrep”
<i>mana’u</i> - “të dish, të njohësh”	<i>imana</i> - “të dish, të njohësh”

Në listën e fjalëve të paraqitur më sipër, fjala Armene “*oror(el)*” – “*tund, përkund; nanuris, vë në gjumë*” dhe ajo Rapa Nui “*Taruriruri*” – “*tund, përkund*”, që gjithashtu mund të lexohet në gjuhën Armene “*tar-orori*” = (*përkund*), mund të gjendet në hymnin Sumerian:⁵⁰

*“U-a a-u-a in my ururu chant may he grow big, In my ururu-chant may he grow large, Like the irina-tree may he grow stout of root, Like the shakir-plant may he grow broad of crown”.

Fjala sumeriane⁵¹ “*ururu*” përkon me fjalën Armene “*oror*” ose “*ororel*”, që ka edhe të njëjtin kuptim, “*tund, përkund; nanuris, vë në gjumë*”.

Këtu është një listë e pjesëshme e fjalëve e hartuar nga Sumerologu, Armen Davtian:

⁵⁰ *Shënim V. Setian*: Një chant i krijuar nga gruaja e Shulgi, një sundues i Dinastisë së Tretë të Urit. Përkthyer prej Samuel Noah Kramer. Shih: Adams, G. (1986). Letërsia e parë për Fëmijë? Rasti për Sumer.

**Shënim B.P.*: Për të mos e deformuar më tej hymnin Sumerian gjatë përkthimit në gjuhën Shqipe, po e lë siç është në përkthimin Anglisht të autorit V. Setian.

TABELA 10a: Ngjashmëritë Sumeriano-Armene

<u>Sumeriane</u>	<u>Armenisht</u>
<i>Ab, ap</i> - “breg”	<i>ap</i> - “breg”
<i>Agar</i> - “fushë”	<i>agar</i> - “fushë”
<i>gin</i> - “me shkue, të shkosh”	<i>gnal</i> - “me shkue, të shkosh”
<i>gurun</i> - “pranverë”	<i>garun</i> - “pranverë”
<i>guskin</i> - “ar”	<i>voski</i> - “ar”
<i>ka-izi</i> - “shkëndijë”	<i>kaitz</i> - “shkëndijë”
<i>ki-mah</i> - “skelet”	<i>kmakhk</i> - “skelet”
<i>nagga</i> - “argjend”	<i>anag</i> - “argjend”
<i>tur</i> - “derë”	<i>door</i> - “derë”

TABELA 10b. Ballafaqimi i fjalëve të gjuhës Armene të ndodhura në “Tabelën 10a” me fjalët përkatëse në gjuhën Shqipe.

Transkriptimi është bërë duke ju referuar dialektit Armeno-Lindor (majtas) dhe atij Perëndimor (djathtas).

<u>Armenisht</u>		<u>Shqip</u>	
Si shkruhet	Si lexohet	Kuptimi	
<i>ալի</i>	<i>ap</i>	breg	breg
<i>ազար</i>	<i>agar, akar</i>	fushë	fushë (ugar ??)
<i>գնալ</i>	<i>gnal, knal</i>	me shkue, të shkosh	dal, me shkue, të shkosh
<i>գարուն</i>	<i>garun, karun</i>	pranverë	pranverë
<i>նոսի</i>	<i>voski, vosgi</i>	ar	ar, flori
<i>կայծ</i>	<i>kaic, gajx</i>	shkëndijë	shkëndijë (gacë ??)

կմախք	kmakhk, gmahk	skelet	skelet
*արծաթ	* <i>arcat'h, arxat</i>	argjend	argjend
դուր	durr, turr	derë	derë

Sumerianët e konsiderojnë veten e tyre si një popull malësor dhe pikturat e tyre janë realizuar në një majë mali. Më poshtë paraqitet një vulë dylli Sumeriane, që tregon një “Sumerian” mbi një majë mali.

Piktografikat dhe hieroglifet, që ne mund të gjejmë eventualisht në Sumeri, tashmë janë të dukshme edhe në Armeni dhe është fakt, që Sumeria atëkohë ishte nën ujë (ishte e përmbytur). Kështu, lidhja e gjuhës Sumere me gjuhët Dravidiane ose përmendja e Sanskritishtes është duke e humbur fuqinë, përfshirë edhe punimet e Arumugam Sathasivam, që është duke u përpjekur të lidhë gjuhën Sumere me



⁵² *Shënim V. Setian: Dorëshkrim i pabotuar.*

atë Dravidiane në dorëshkrimin e tij⁵², “*Gjuha Sumeriane: Një gjuhë Dravidiane*”, e cila u mor me njëfarë serioziteti prej gjuhëtarit dhe përkthyesit të artefakteve të lashta, Kurt Schildmann (1909-2005). “Gjuha Sumeriane është mjaftueshëm e ndryshme si nga gjuha Elamite ashtu edhe nga ajo Dravidiane sa për të më bërë mua të mendoj se ka një lidhje speciale ndërmjet tyre”, vërejtja Bomhard (1997), i cili është shumë i afërt me pjesën më të madhe të konkluzioneve, përse i përket kësaj çështjeje.

Duke u kthyer tek kumtesa e Kampbellit (Campbell) duhet thënë se, ka qenë mjaft e guximshme të deklarohet, që aplikimi i metodave të përshtatshme mund të çojë në zbulimin e lidhjeve të reja gjenetike për disa gjuhë të izoluar, ndonëse “nuk mund të pritët, që do të jenë shumë raste të tilla, dhe kjo është shumë ndryshe në rastin e gjuhës Baske” (Fq. 13). Ai përdori Trask (1995) dhe Lakara (1996, 2006) si mbështetje për mendimin e shprehur, që gjuha Baske tashmë ka treguar, që propozimet e bëra nuk e mbështesin supozimin e një lidhjeje gjenetike ndërmjet gjuhës Baske dhe ndonjë gjuhe tjetër apo familje gjuhësh. Tek Kampbelli është gjetur edhe një tjetër problem dhe nuk është e qartë nëse ai e ka ditur, që fjala Armene “*Arç*”, që shkruhet “*urç*”, nënkupton “*ari*” (kafshën) dhe tingëllon njëlloj si në gjuhën Baske “*hartz*”, që do të thotë po “*ari*”, ndonëse ai përpiket ta lidhë atë ndryshe. Interesant është fakti që, prej gjuhëtarëve të ndryshëm gjuha Akuitanian ka qenë supozuar të ketë qenë e lidhur dhe të jetë lidhja me gjuhën Baske. Duke ju referuar Mikelenës (Michelena) (1964), fjalët Akuitane përbëjnë dëshminë më të lashtë të gjuhës Baske. Trask (1995,1997) pohon se “tashmë ka mundësi, që të gjithë studjuesit e gjuhës Baske të pranojnë, që Baskët rrjedhin, pak a shumë, prej Akuitanëve”. Kampbelli (2008) na jep një listë me fjalë Akuitane për t’i krahasuar me ato Baske, si p.sh.: Akuitan. – “*arikso*” (*lis*) dhe Bask. – “*haritz*” (*lis*); Akuitan. – “*ausci*” (*ar, flori*) dhe Bask. – “*euske(ra)*” (*ar, flori*). Kjo është vërtet interesante, pasi në gjuhëm Armene, fjala “*hariç*”, që shkruhet “*hurnjɑ*” nënkupton “*lis*”, dhe fjala “*voski*”, që shkruhet “*nuljɑ*” nënkupton “*ar, flori*”. Kështu kemi:

<u>Armenisht</u>	<u>Akuitan</u>	<u>Baskisht</u>	<u>Shqip</u>
hariç	arikso	haritz	lis
voski	ausci	euske(ra)	ar, flori

një lidhje ndërmjet Armenisht, Akuitan, Baskisht, një moment kritik ky, që duhet marrë në konsideratë, por që përsëri mungon në punimet e tyre. Në fakt, Sumerianët, për fjalën “ar, flori” ose “para, lekë” përdoret “guskin”. Kështu, ne kemi: Arm. “voski”, Sum. “guskin” dhe Bask. “euske(ra)”. Nëse Kampbelli e bëri këtë krahasim ndërmjet gjuhës Baske dhe asaj Akuitane në vitin 2008, është e çuditshme, që ai nuk shfrytëzoi një artikull të publikuar 8 (tetë) vjet më parë nga Sarkisian (2000), të shtypur në revistën spanjolle *Fontes Linguae Vasconum*⁵³

Ju lutem, më lejoni, të theksoj një moment të rëndësishëm nga ky informacion: “*Fontes Linguae Vasconum*” ka lidhje me një revistë të lingistikës Baske, në të cilën analizohen aspekte të ndryshme të gjuhës Baske, revistë kjo që publikohet nga Qeveria e Navarrës që nga viti 1969. Faktikisht, Sarkisiani paraqiti një analizë të teorisë së vazhdimësisë gjuhësore Basko-Akuitane duke shfrytëzuar informacione, që kishin lidhje me gjuhën Armene dhe gjuhë të tjera nga Azia e Afërt, veçanërisht me atë Hurriane dhe Urartiane. Për të qenë më korrekt me lexuesin, unë po sjell një fragment nga artikulli (kumtesa)⁵⁴:

“Studimi bazohet në ekzistencën e një numri të madh përputhesh rastësore (koincidencash) ndërmjet gjuhës Baske dhe asaj Armene, të cilat pjesërisht mbështeten nga studimi i onomastikës Akuitane. Janë zbuluar tre tipe ngjashmërisht Akuitan-Basko-Armene në këtë studim: takime fonetike, baza onomastike dhe forma gramatikore. Ndër të parat, mungesa e tingullit *R* në një pozicion fillim fjale, mospranimi

⁵³ *Shënim V. Setian*: navarra.es-Gobierno de Navarra.

⁵⁴ *Shënim V. Setian*: Sarkisian V. (2000) *Contribucion a los estudios aquitano-vascos* “Contribution to Aquitano-Basque Studies”.

i grumbullimit të bashkëtingëlloreve në grup, mungesa e tingullit *f*, vështirësia që haset me shqiptimin e strukturave të bashkëtingëlloreve të heshtura+rrjedhëse (*mute+liquid*) (*tl, pr, kl*, etj.) dhe shfaqja shumë e rrallë e germës *-a* në pozicion fundor (në fund të fjalës) ja vlen të theksohen. Janë dhënë pothuajse 30 përputhje rastësore (koincidenca) rrënjësh onomastike, si p.sh.:

<u>Akuitan</u>	<u>Baskisht</u>	<u>Armenisht</u>
<i>andere, andos</i>	<i>andia</i> (i madh)	<i>andranik</i> (fëmija i parëlindur, më i madhi)
<i>erdenivis</i>	<i>erdi</i> (gjysëm);	<i>herx(el)</i> (pres, ndaj)
<i>ombecco</i>	<i>umme</i> (fëmijë, i sapolindur)	<i>hambak</i> (fëmijë)
<i>sahar</i>	<i>zar, zahar</i> (i vjetër, plak)	<i>cer</i> (i vjetër, plak)

etj., etj. Janë analizuar gjithashtu, një numër pikëtakimesh gramatikore.”

Shkalla e heshtjes dhe e lënies mënjanë të mbështetjes së studimeve të përshtatshme, siç janë ato të Sarkisianit, është e kuptueshme, veçanërisht kur ato kanë informacione kritike, të cilat mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme drejtimin e çështjes fillestare ose detyrojnë futjen e hipotezave alternative. Për fat të keq, kjo është vetëm maja e ajtsbergut. Sidoqoftë, diçka interesante ndodh kur ne i analizojmë këto çështje, që i përkasin kësaj teme, në ambientet akademike: Ne tentojmë të vëmë në dukje jo vetëm se si keqinterpretimet, të qëllimshme apo të rastësishme, ngjisin si një thumb që të hyn në gisht, por edhe se si ato janë të ndërlidhura dhe bashkohen apo janë pjesë e botimeve të ndryshme. Le ta tregojmë këtë me shembulla.

Siç është përmendur tashmë, puna e Kampbellit përmend

punën e Traskut. Robert L. Trask (1944-2004) ka qenë Profesor i Gjuhësisë në Universitetin e Susseksit dhe, i konsideruar ekspert në gjuhën Baske dhe gjuhësinë historike, mbeti i heshtur mbi lidhjet e gjuhëve Basko-Armene, përfshirë edhe mungesën e dyshimtë të saj në veprën e tij “Diksionari Etimologjik i Gjuhës Baske” prej 418 faqesh⁵⁵. Gjithashtu, është e çuditshme që revista “Araksës”⁵⁶ - bashkëpunore Basko-Spanjolle-Armene, e cila ka publikuar një fjalor me më tepër se 600 terma afërsisht identike ndërmjet gjuhës Baske dhe asaj Armene, nuk është përmendur në punimet e Traskut. Ishte shumë e çuditshme për Traskun (1995) ta pranojë këtë si një dështim për të gjetur ndonjë të afërm për Baskët, dështim ky, sipas tij, “që nuk vjen për mungesë të dëshirës për t’u përpjekur”, në një kohë kur ka shfaqje të bollshme për të kundërtën. Nuk është më e pranueshme për studjuesit të mohojnë një lidhje të mundshme ndërmjet dy apo më shumë gjuhëve pa marrë në konsideratë shfaqjet dhe faktet elementare, dhe jo më tej e falshme të mohohen lidhje të tilla të konsiderueshme nën maskën e shprehjes “e panjohur”. Ky duhet të jetë një tregues i qartë i faktit, që ne nuk kemi të bëjmë me mungesën e dukurisë, por me një neglizhim të turpshëm dhe lënien mënjanë të lidhjeve ndërmjet grupeve të fjalëve, që deri në një farë mase zbulon një harresë të qëllimshme.

Trask ju bashkëngjiti Lakarës⁵⁷ së bashku me studjues të tjerë të fushës, për të publikuar një punim voluminoz lidhur me gjuhën dhe historinë Baske, duke përfshirë këtu edhe shërbimin si botues në

⁵⁵ *Shënim V. Setian*: Trasku vdiq në Mars 2004, duke e lënë dorëshkrimin e tij të pambaruar - “Diksionari Etimologjik i Gjuhës Baske”. Ai u shtyp dhe u publikua nga Maks M. Webber pas vdekjes së tij. Trask u mbështet shumë në punimet e Mikelenës.

⁵⁶ *Shënim V. Setian*: Në vitin 1993, Qendra Armene e Universitetit Shtetëror të Erevanit themeloi Revistën Shkencore Ndërkombëtare Armeno-Baske me emërtimin “Araksës”, e cila mbahej me kontributin e Armenologëve dhe Baskologëve nga vende të ndryshme të botës.

⁵⁷ *Shënim V. Setian*: Joseba A. Lakara, professor në Departamentin e Linguistikës dhe të Studimeve Baske në Universitetin e Vendeve Baske (Euskal Herriko Unibertsitatea “EHU” – Universidad del País Vasco “UPV”).

publikimin e “Drejt një historie të gjuhës Baske” (1995), një përmbledhje me 12 artikuj të veçantë prej gjuhëtarëve dhe historianëve të ndryshëm. Publikimi përfshiu, gjithashtu, një artikull nga Luis Michelena⁵⁸ (1915-1987), me emrin original të Koldo Mitkselena Elissalt, një gjuhëtar i shquar Bask, që dha mësim në Universitetin e Vendeve Baske dhe ishte antar i Akademisë Mbretërore të Gjuhës Baske.

Mikelena⁵⁹ është një nga figurat qëndrore, që duhet marrë në konsideratë lidhur me këtë temë, pasi mund të thuhet se ai ka qenë ndër të parët, që janë marrë me analizën e zhvillimeve të hershme të gjuhës Baske. Puna e tij mbi gjuhën proto-Baske mund të thuhet që ka qenë e fokusuar kryesisht në periudhën ndërmjet shekullit të 5^{të} BCE dhe shekullit të 1^{të} CE, që vështirë se mund të konsiderohet e shtrirë në periudhën e duhur kohore, për aq sa ne të mund ta konsiderojmë atë “Proto-Baske”. Sipas ekzaminimeve të tij, përfshirë rindërtimet e brendshme, variantet e fjalëve dhe huazimet e fjalëve, mund të thuhet që ai është nbështetur tek zbulimet e mbishkrimeve Akuitane, ku Trask (1997) sugjeronte, që shumica e kërkimeve të tij është bërë përpara se të gjendeshin mbishkrimet Akuitane. Interesante është se, Trask, Lakara dhe Joaquin Gorrochategui Churruca (lindur 1953), një gjuhëtar Baskolog dhe Spanjolog ishin nga të paktët kontribues në rrugëtimin e tij gjatë kësaj pune, ndërsa Lakara e vazhdoi më tej ekzaminimin e tij në fushën proto-Baske, duke e shtrirë fushën e ekzaminimit edhe në periudhën kohore përpara shekullit të 5^{të} BCE. Ky është momenti, ku çështja fillon të bëhet më interesante. Gjuha Akuitane është konsideruar të jetë gjuha nga ku mund të ketë prejardhjen gjuha Baske, ose gjuha Akuitane dhe gjuha Baske kanë të njëjtën rrënjë (dalin nga i njëjti burim; janë gjuhë motra)

⁵⁸ *Shënim V. Setian*: Mikelena është autor i më shumë se 260 artikujve dhe librave në karrierën e tij.

⁵⁹ *Shënim V. Setian*: Ajo merr kuptim të përgjithshëm vetëm për të nxjerrë në dukje se gjuha e tanishme e unifikuar Baske ka ekzistuar vetëm në imagjinatën e Michelenës, i cili e prodhoi atë artificialisht për konsum të politikanëve” – Jesus Garcia Castrillo (lindur 1947), Profesor i Gjuhës dhe Letërsisë.

(shih Trask, 1995, Trask, 1997), ku Luis Michelena dhe Gorrochategui (1985, 1989)⁶⁰, gjithashtu, gjetën një lidhje Akuitano-Iberiane, që mund të ndahej edhe me atë Baske. Tashmë, Pirrenejtë janë kyçi i gjithë kësaj, pasi shumica e mbishkrimeve Akuitane, që janë gjetur në veri të Pirrenejve, i përkasin sferës Akuitane, ndërsa ato të gjetura në jug të territorit janë të sferës Baske (Vaskonik).

⁶⁰ *Shënim V. Setian*: Lengua aquitana y lengua gala en al Aquitania etnografica, Symbolae ludovico Mitxelena septuagenario oblatae, Vol. 1, 1985; La onomastica aquitana y su relacion con la iberica, Lengua y cultura en hispania preromana: actas del V Coloqui sobre lenguas y culturas de la Peninsula Iberica: (Colonia 25-28 de Noviembre de 1989)/ coord. with Francisco Villar, Jyrgen Untermann, 1993.

GJUHA DHE LUFTA E HIPOTEZAVE

“Sepse pa gjuhën tonë, ne kemi humbur vetveten [identitetin]. Kush jemi ne pa gjuhën tonë?”

Melina Marketta (Melina Marchetta)

Disa pak fjalë mbi betejat e gjuhës, dhe këtu mund të fillojmë me *Gynter et al.* (2015). Ata patën një studim dhe rezultate mjaft interesante. Nga njera anë, ata ishin peng i pohimit se gjuha Baske ishte një gjuhë e izoluar nga pikëpamja gjuhësore (linguistike), me “asnjë provë afërsie me ndonjë nga gjuhët, që fliten tashmë në Europë ose diku tjetër”, duke përsëritur kështu pikëpamjen e Kurlanskit dhe shumë të tjerëve. Nga ana tjetër, vrojtimet e tyre mbi lidhjet gjenetike japin mendimin, që Baskët dhe gjuha e tyre të mund të jenë të lidhura me përhapjen e agrikulturës gjatë kohëve Neolitike, duke pranuar faktin, që origjinat e mbjelljes dhe agrikulturës e kanë filluesën e tyre në Lindjen e Afërt⁸⁴ rreth viteve 11 000 BP⁸⁵. Nëqoftëse rezultatet e tyre janë të sakta, atëhere rezulton që Baskët janë pasardhës të agrikultorëve, të cilët erdhën “së fundmi nga Lindja e Afërt” (Pereltsvaig, 2015). Ndonëse rezultatet e *Gynter*

⁸⁴ *Shënim V. Setian*: Lindja e Afërt, ose në rastin tonë Lindja e Afërt e Lashtë, shihet nga arkeologët dhe historianët e lashtë si zona e Mesopotamisë që përfshin Sumerët, Malësitë Armene, Levantin, Persinë dhe Egjiptin e Lashtë.

⁸⁵ *Shënim V. Setian*: BP = Përpara Fizikës (Shënim B.P.: Shkurtesa “BP” është interpretuar në mënyrë retrospektive si “Para Fizikës”; që i referohet kohës përpara se testimi i armëve bërthamore të ndryshojë artificialisht proporcionin e izotopeve të karbonit në atmosferë, duke bërë që datimi pas kësaj kohe ka të ngjarë të mos jetë i besueshëm).

et al. janë më tepër në favor të Hipotezave të Stepës⁸⁶ se sa të Hipotezave Anatoliane, Pereltsvaig (2015) pati probleme me të. U konsiderua se rezultatet e *Gynter et al.* tregojnë për lidhje të Baskëve me agrikulturalistët, ndonëse, ajo do ta kishte të vështirë të pranonte të dy llojet e rezultateve, pasi, të pranosh konkluzionet e tyre në përgjithësi, do të kërkonte “bërjen e supozimeve të çuditshme, të pambshtetura në të dhëna gjenetike, gjuhësore apo arkeologjike”. Në të njëjtën kohë, Profesor Mattias Jakobson i Universitetit të Upsalës pohoi, që konkluzionet e tyre (*Gynter et al.*) tregojnë se Baskët e gjurmojnë prejardhjen e tyre në grupet e hershme bujqësore nga Iberia, gjë që bie ndesh me pikëpamjet e mëparshme rreth tyre si mbetje të një popullsie, që gjurmon prejardhjen e vet në grupet gjahtarë të periudhës Mezolitike.

Shumë presion është ushtruar mbi gjuhën Baske për ta çliruar atë nga konsideratat si gjuhë e izoluar, edhe pse alternativat e propozuara krijonin shqetësime të tjera. Propozime të tilla janë bërë nga Rowley-Conwy (2011), të cilët vinin në dukje se gjuha Baske, që normalisht konsiderohej si e palidhur me ndonjë gjuhë tjetër, në fakt mund të kishte lidhje me gjuhë të tjera të izoluar, duke sugjeruar lidhje me Pakistanin e veriut përsa i përkiste fjalorit, që kishte lidhje me bagëtinë, delet, dhitë, drithërave që kultivoheshin dhe punimit të tokës. Busulla, siç dukej, nuk dukej të kishte gjetur orientimin e saj në mes të gjithë këtyre ideve, që tërhiqeshin dhe shtyheshin mes tyre në grumbullin e madh të alternativave të tilla. Interesant është fakti që, sipas studimeve të Weale dhe kolegët e tij (2001) si edhe Wilson dhe kolegët e tij (2001), të cilët kanë vëzhguar një element të rëndësishëm të haplotipit 3, të quajtur si “Atlantic Modal Haplotype”*, të rezultojë që këto të jenë modalë në Uells, vendet Baske dhe Irlandë

⁸⁶ *Shënim V. Setian*: Në kontrast me Hipotezën e Stepës, Hipoteza Anatoliane deklaroi se Indo-Europianët origjinalë janë agrikulturalistët e Lindjes së Afërt. Me “Anatolian” ata nënkuptojnë krahinën e Malësive Armene.

**Shënim B.P.*: Haplotype = a set of genetic determinants located on a single chromosome. Haplotype = një grup përcaktuesish gjenetikë të vendosur në një kromozom të vetëm.

Duke supozuar që kjo është një shenjë e popujve Paleolitikë në Europë, kërkuesit kanë argumentuar që “Atlantic Modal Haplotype” është gjetur gjithashtu në në mostra të veçuara rajonale të izoluara të krahinave Armene të Sjunikut (7.9%) dhe Karabakut (2.8%). Gjithashtu, duhet marrë në konsideratë që R1B e ka filluesën në “Anatolia” dhe ka një frekuencë të lartë të saj në vendet Baske (Lajoni, Kalafell, dhe Bertanpetit, 2010). Kavali - Sforca (Cavalli-Sforza) (1988) ndjekin një perspektivë kryesore duke argumentuar që do të ishte e vështirë të kundërshtohet plotësisht alternativa e hipotezës se gjuha Proto-Baske ka qenë folur prej bujqve të epokës së hershme Neolitike, që banonin në Azinë e Vogël, dhe pastaj është përhapur prej tyre drejt Europës rreth 9 000 ose më shumë vjet më parë, ku ka vazhduar të flitet në zonat më të humbura (zonat e izoluara, zonat që janë shumë pak në kontakt me qytetërimin e zhvilluar). Në të njëjtën kohë, Kavali – Sforca i konsideruan gjuhën Baske dhe gjuhët me origjinë Uralike në Skandinavi dhe Hungari, si gjuhë që nuk bënin pjesë në pemën e gjuhëve Indo-Europiane, ndërkohë duke pranuar idenë se gjuha Proto-Baske mund të jetë folur me bujqit që braktisën Azinë e Vogël (Lindja e Afërt, Azia Perëndimore, Malesitë Armene) dhe u shpërndanë në “të gjitha drejtimet”, përfshirë edhe Europën, ku të dhënat janë vërtetuar në rrugë arkeologjike dhe gjenetike. (shih Fq. 133). Është e rëndësishme të shënohet se Pereltsvaigu nuk duket të jetë në favor të hipotezës së origjinës Indo-Europiane nga Malësitë Armene. Ajo ka përdorur termin – “Anatolia”⁸⁷ si një zëvendësim i përsëritur i emrit të asaj krahine që afron më tepër të quhet Azia e Vogël, dhe pozicioni i saj në këtë çështje lyp shqyrtimin gjithashtu, atje ku vetë skepticizmi i saj është i dyshimtë.

⁸⁷ *Shënim V. Setian*: “Anatolia” dhe “Malësitë Armene” janë të lidhura edhe nga pikëpamja gjeografike, kështu që do të duhej sforcim për të kuptuar, se cilës sipërfaqe i referohet Hipoteza Anatolike/Malësitë Armene, pa pasur të përcaktuar ose përshkruar diferencën ndërmjet të dy “zonave”, të cilave i referohen studjuesit për të vendosur në kërkimet e tyre respektive. Malësitë Armene dhe shtrirja e tyre në parahistori përfshin sipërfaqe ku janë zbuluar shumë origjina civilizimesh njerëzore. Nëse Malësitë Armene përfshijnë ose jo Anatolinë, kjo luan një rol të dorës së dytë për të kuptuar diferencën ndërmjet Hipotezës Kurgan dhe asaj Anatoliane.

Ajo duhet të marrë në konsideratë punën monumentale të Tomas V. Gamkrelixe (Thomas V. Gamkrelidze) and Vjaçesllav V. Ivanov (Vyaceslav V. Ivanov) mbi pemën e gjuhës Indo-Europiane, ose punimet e Kuentin D. Atkinson (Quentin D. Atkinson), siç është studimi i bërë nga Pagel, Atkinson, Kalude (Calude) dhe Meade (2013), ku ata konkluduan se superfamilja gjuhësore ka dalë nga një paraardhës i përbashkët ose nga një paragjuhë, e cila formonte rrënjën e përbashkët për rreth 7 familje gjuhësore sot, që e kanë origjinën dhe janë folur “në dhe rreth zonës ku shtrihet Turqia e ditëve të sotme, dhe më sipër deri në Irak, i cili asokohe ka qenë njohur si Mesopotamia” (Wallis, 05 Korrik 2013). Kjo shënon vendin e ashtuquajtur Malësitë Armene, të cilat shtriheshin përgjatë Turqisë së sotme, deri në Gjeorgjinë e sipërme dhe deri poshtë në Mesopotami, e njëjta zonë të cilën kërkuesit si Gamkrelidze dhe Ivanov e kanë shmangur (lënë mënjanë) për më shumë se 30 vjet, duke përfshirë këtu edhe shumë studjues të tjerë të këtyre 200 vjetëve të fundit. Pavarësisht nga bombardimi i vazhdueshëm i dukurive dhe zbulimeve shkencore rreth domethënies (rëndësisë) së Malësive Anatoliane/Armene si shtëpia e gjuhëve Indo-Europiane, e zbutjes së kafshëve shtëpiake, e agrikulturës, metalurgjisë, endjes dhe shumë elementeve të tjerë thelbësorë të civilizimit, ka nga ata që shtyjnë alternativa të tjera.

Hipoteza Kurgan e shtrirjes së gjuhës Para-Indo-Europiane, fillimisht e parashtruar nga Maria Gimbutas, reflekton idenë, që blegtorët nomadë filluan përhapjen e tyre në mijëvjeçarin e 4^t BCE, dhe gjatë mijëvjeçarit të 3^{te} BCE u shtrinë përgjatë stepave Pontiko-Kaspikë dhe në Europën Lindore. Sipas Xhejms Patrik Malory (James Patrick Mallory), një Indo-Europeanist Skocez, zgjidhja Kurgan është tërheqëse dhe ka qenë pranuar prej shumë arkeologëve dhe gjuhëtarëve, pjesërisht ose plotësisht, të cilët duket se e lidhin me idenë e kuajve (zhvillimit të përdorimit të kuajve). Përkrahësit e teorisë Kurgan argumentojnë se, historia e fjalëve Indo-Europiane për “kalë” tregon se folësit Para-Indo-Europeanë kanë jetuar për një kohë të gjatë në zona ku kali ka qenë kafshë vendase ose shtëpiake e zbutur (Mallory, 1989). Publikimi i Antonit (Anthony) (2010) është jashtë mase mbështetës i Hipotezës së

Stepës dhe i shtoi karburant të konsiderueshëm konsideratës për të. Duke lidhur mbetjet arkeologjike parahistorike me zhvillimin e gjuhës, është argumentuar që popujt parahistorikë të kullotave në stepat e Eurazisë qëndrore kanë qenë folësit originalë të gjuhës Para-Indo-Europiane. Antoni theksoi përdorimin krijues nga ana e tyre e qerreve (karrocave), udhëtimit mbi kalë, dhe të koçive⁸⁸, gjë që i shndërroi stepat Euroaziatike në një nyje komunikimi, tregtie dhe bashkëpunimi ndërkulturor. Problemi me këtë pikëpamje qëndron në faktin se, nëqoftëse ne do ta trajtojmë problemin duke pasur në qendër të vëmendjes “kalin”, atëherë do të duhej të shkonim në rajonin e Shengevitit në Armeni për të përcaktuar shtrirjen dhe qendrën e Rëndësisë të një civilizimi të zhvilluar, që do të eklipsonte çështjen e “Blegtorëve nomadë” (Setian, 2014). Konkluzionet e Antonit hasën në një kundërgargument kur gërmimet e bëra në Armeni në rajonin e Shengevitit e detyruan Hans Peter Wertmann të deklaronte se ai nuk kishte parë aq shumë nofulla dhe mbetje kuajsh në të gjithë Lindjen e Lashtë se sa kishte parë në Armeni. Në Armeni nuk ishte e dukshme vetëm zbutja dhe përdorimi i kalit, por fjala “kalë” ishte e lidhur me vetë gjuhën Armene. Pedersen dhe studjues të tjerë, përfshirë Lamberterie (1978), sugjeruan që fjala Armene “esh”, që përdoret për “gomar” reflekton emrin e vjetër Indo-Europian për kalin, ku “procesi mund të përshkruhet si një reaktion zinxhir gjatë të cilit zgjerimi i sferës së përdorimit për efekte poetike termi “xhi” çoi në një ndryshim të kuptimit në sinonimin e tij “esh” (Ivanov)⁸⁹. Përveç kësaj, Ivanovi argumentoi se studimi i Werner Winter⁹⁰ rreth fjalës parashtronte që emri Hurrian për kalin ishte huazuar nga gjuha Armene, duke hasur vështirësi semantike, atje ku ndërkohë duke huazuar atë fjalë nga Armenishtja, ajo do të kishte pasur kuptimin original Indo-Europian, gjë që më vonë ndryshoi.

⁸⁸ *Shënim V. Setian*: Azzaroli (1985) gjeti që qerre të paprekura, të cilat ishin gjetur në Tebë, ishin të përbëra prej një lloj druri, që kishte ardhur nga Armenia, dhe koçitë kishin shkuar në Egjipt si tribut nga Mittani.

⁸⁹ *Shënim V. Setian*: Shënime krahasuese mbi gjuhët Hurro-Urartiane, të Kaukazit Verior dhe asaj Indo-Europiane.

⁹⁰ *Shënim V. Setian*: Lamberterie, 1978, 262-266, n.1.

Kështu fjala për “kalë” i përket termave Armene, që korrespondojnë me gjuhën poetike të Vedave (Hubschmann, 1897; Acharian, 1971; Greppin, 1978), gjë që mund të përcaktojë përse ajo është parë si një fjalë Indo-Europiane, e cila është përthithur në gjuhën Urartiane dhe më vonë nga disa dialekte të Kaukazit Veri-Lindor, siç është Nakh, Dargwa, Lak dhe Lezgian. Më pas Ivanovi pohoi që fjala Armene për “kalë”, e cila në formë mund të jetë një përputhje normale me atë Indo-Iraniane, mund të ketë qenë një nga burimet nga ku është huazuar në gjuhën Gjeorgjiane dhe ato të Kaukazit Veri-Lindor. Në kundërshtim me këtë pikëpamje, fjala Sumeriane “anse” e përdorur për “gomar”, është parashtruar nga Benveniste⁹¹ si e huazuar nga Kaukazi Veri-Lindor, gjë që duket në kundërshtim me provat, pasi ne kemi “asto” në gjuhën Baske dhe “esh”⁹² në gjuhën Armene të përdorur për “gomar”. Pisani (1959) pranoi lidhjet ndërmjet gjuhës Sumeriane dhe asaj Armene në shumë nga termat.

Grindjet e vazhdueshme ndërmjet përkrahësve të Hipotezës Anatoliane dhe asaj të Stepës (e njohur gjithashtu edhe si Hipoteza Kurgan) duket se humbasin një pikë thelbësore: “të dyja mund të jenë njëherësh të vërteta” (Gray et al., fq. 1092), pasi vendi Stepë mund të shihet si “vendpushimi i rradhës” i grupit apo tribuve, që vendosën të largohen nga Pllaja/Malësitë Armene. Për më tepër, emigrimi i Indo-Europianëve nga Malësitë Armene (p.sh. Azia e Vogël) ka ndodhur së paku rreth 3000 vjet përpara kohës së supozuar të shpikjes së rrotës (Balter, 2016)⁹³. Në kërkimet e Hovhannisyan et al.’s (2014), grupi Europian, që përmban Baskët, Siçilianët dhe Belgët, është i bashkuar me haplogrupin R1b1a2-M269 dhe I-M170, të dy mjaft të përhapur në Europë, ku i pari ishte një shënues për migrimin

⁹¹ *Shënim V. Setian*: Shih: Ernout & Meillet (1994)

⁹² *Shënim V. Setian*: Termi Anglez “ass” rrjedh nga Armenishtja e vjetër “esh”, në ngjashmëri me fjalën Sumeriane “anse” dhe Baske “asto”. Në gjuhën Galeze ajo është “asal”, në gjuhën Gjermane “esel” dhe në atë Ruse “asiol”.

⁹³ *Shënim V. Setian*: Michael Balter është gjithashtu autor i “Perëndesha dhe Demi” (Free Press, 2005), që eksploron gërmimet në Çatalhoyuk, një nga fshatrat më të hershëm dhe më të mëdhenj të botës.

Neolitik. Për më tepër, Kavali-Sforca argumentuan se “edhe sikur të pranohej qendra e origjinës sipas Gimbutas (kultura Kurgan në Rusinë Europiane Jugore), nuk është detyrimisht e nevojshme që kjo të jetë qendra primare nga ku filloi shtrirjen gjuha Indo-Europiane Ajo mund të jetë e dyta” (fq 135). Hovhannisyán et al.’s (2014) gjeti se konditat klimaterike të përshtatshme dhe pozicioni i favorshëm gjeografik i Malësive Armene shërbeu si vendqëndrim për disa valë dyndjesh për agrokulturistët e parë nga Lindja e Afërme për në Europë dhe Kaukaz, duke sugjeruar të paktën dy rrugë migratore që përfshinin një shteg perëndimor përgjatë bregdetit Mediterran (Detit Mesdhe) dhe një shteg verior drejt Kaukazit të Veriut. Rezultatet e tyre mbështetën si modelin kalimtar të Malësive Armene ashtu edhe rrjedhën e mundshme të genit nga epoka Neolitike, i cili u nda ndërmjet popullsive Armene dhe atyre Ballkanike. Në lidhje me Ishujt Kanarie, një arqipelag Spanjoll larg bregdetit të Spanjës veriperëndimore, Feliks fon Lushan (Felix von Luschan) dhe Hans Majer (Hans Mayer) kanë një pikëpamje antropologjike të migrimëve Indo-Europiane në Europë dhe gjetkë. Ata argumentuan...

Ata argumentuan se tipi Armen, i bashkuar me Indo-Europianët dhe si pasojë me Arianët është konsideruar të ketë qenë i lidhur me popujt vendas (indigjenë) të Kanarieve (Luschan, 1896, Meyer, 1896). Luschan, pasi ekzaminoi materialin antropologjik të mbledhur nga Lindja e Afërme, erdhi në përfundimin që rezidentët e parë të Mesopotamisë⁹⁴ dhe Anatólisë⁹⁵ (më saktësisht Azia e Vogël, Lindja e Afërme ose Azia Perëndimore⁹⁶) kanë qenë të tipit Armen dhe më pas

⁹⁴ *Shënim V. Setian*: “Gjithçka që është njohur në Mesopotami vjen nga Armenia dhe që Armenia është fragmenti mungues në mozaikun e plotë të ngritjes të civilizimit të botës së lashtë.” – Mitchell S. Rothman, Profesor në Antropologji dhe Arkeologji dhe themelues i Departamentit të Antropologjisë në Universitetin Widener në Chester, Pensilvani.

⁹⁵ *Shënim V. Setian*: Në mënyrë të kuptueshme, termi “Anatolia”, prej Greqishtes Anatolia (Ανατολία), duke pasur kuptimin “Lindje e Diellit”, ka pas qenë përdorur nga kërkuesit dhe Akademikët për të treguar Azinë e Vogël, që është e njëjta gjë me Malësitë Armene. Përdorur nga Collin Renfrew.

⁹⁶ *Shënim V. Setian*: Nalbandian (1974) përsëriti se “Azia Perëndimore” dhe “Lindja e Afërme” janë shprehje dhe përcaktime korrekte për t’u përdorur.

ka arritur edhe tipi Mediteran⁹⁷ (Mesdhetar). Më pas, Luschan vërejt se, “ndërsa “Turqit” dhe “Grekët” është provuar të jenë të përbërë së paku nga dy elemente qartësisht të dallueshëm somatikë, i treti nga të tre grupet etnike, i cili formon trupin e banorëve të Azisë së Vogël, Armenët, në krahasim me ta është relativisht homogjen, por si rregull masa e madhe e Armenëve formon jo vetëm një besim, por, gjithashtu, një unitet somatik” (Luschan, 1911, fq. 20). Ky vrojtim u konfirmua nga studimet gjenetike 104 vjet më pas, kur Haber et al. (2015) zbuloi se “Armenët nuk kanë ndonjë përzjerje domethënëse me

⁹⁷ *Shënim V. Setian*: Grekët i kanë quajtur “Pellazgët” si populli, i cili ka sunduar tokat përpara se ata të lëviznin në Egje. Natyrisht, Pellazgët origjinalë nuk mund të flisnin gjuhën Helenike. Një nga atributet e mëdha që u është dhënë Pellazgëve është vendosja nga ana e tyre e civilizimit Mikenian rreth para 4000 vjetësh. Problemi është se asnjë shpjegim etimologjik nuk është i kënaqshëm ose i afrohet shpjegimit të emrit të këtyre popujve. Madje edhe Grekët e përmendin që Pellazgët nuk flisnin Greqisht. Arkeologë të ndryshëm e kanë konsideruar kulturën si kulturë të natyrës Neolitike. Mikena është i pari qytet i ndërtuar në Greqi dhe është konsideruar ekstravagant dhe “i artë” nga natyra. A ka vallë mundësi që të ardhurit rishtas Grekë t’i konsideronin banorët vendas dhe fqinjët e tyre Pellazgë si “pajl-azg” (Në gjuhën Armene shkruhet “*իսլլ ազգ*”, lexohet “*pajl azg*”, që do të thotë “*Populli Ndriçues*”) për shkak të nivelit më të lartë dhe natyrës më të zhvilluar? Grekët në shkrimet e tyre nuk shprehin admirim për civilizimin Pellazg. Homeri është një nga të parët që i përmend Pellazgët si edhe afërsitë dhe natyrën e ngjashme me Trojanët. Ne mund të sjellim në vëmendje se Troja është etimologjikisht derivativ (i prejardhur) i emrit të Zotit Armen të Letërsisë, Tir, dhe i zgjatuar me prapashtesën Greke – oi (oj), që i jep asaj kuptimin e saj original Armen. Në mbështetje të mëtejshme të këtij shpjegimi, ne mund të përmendim se qyteti i Trojës është themeluar nga mbreti legjendar i Frigjisë (Phrygia) – Tiros. Madje edhe vetë emri Tir mund të kqyret si emri Armen “Ter”, që do të thotë “Zotërues”, “Drejtuës”, “Sundues”, “Zot”, term, i cili sot aktualisht përdoret edhe për “Mbret”. Ka edhe konsiderata, të cilat e trajtojnë emrin (fjalën) Tir si të prejardhur nga fjala Armene “gir” – shkrim, pasi “Tiri” Armen ka qenë Zoti i Letërsisë. Ne sigurisht mund t’i argumentojmë afërsitë që janë gjetur ndërmjet Armenëve, Pellazgëve, Lidianëve, Frigëve dhe Etruskëve nga disa historianë dhe gjuhëtarë, përfshirë Ellis (1861) dhe Drews (1994) dhe ato nuk do të kalojnë pa u vënë re. Robert Ellis nuk u pajtua me supozimet që George Rawlinson bëri mbi këtë temë, të cilën ai ishte i aftë ta mbështeste me argumentet e tij të bazuara në zbulimet dhe mbetjet gjuhësorë dhe arkeologjike. Për më tepër, afërsitë etimologjike dhe arkeologjike, dhe tani, edhe afërsitë gjenetike, i mbështesin këto nocione të ndërftues (ndërlidhjes) ndërmjet grupeve që rreth 150 vjet më parë konsideroheshin si të tillë (pra si grupe të veçantë). Ja vlen të përmendet edhe një shënim shtesë: “Porta e Luanëve” e Hittitëve, që është ndërtuar në Hatussa në vitin 1400 BCE është pothuajse identike me “Portën e Luanëve” të Mikenës në Greqi.

popullsi të tjera në historinë e tyre të kohëve të vona dhe kanë qenë në këtë mënyrë gjenetikisht të izoluar që nga fundi i Epokës së Bronzit, 3.000 vjet më parë”. Në përputhje me këtë, rezultatet e Hellenthal et al. (2014) treguan që Armenët kanë shumë më tepër afërsi gjenetike me Europeanët Neolitikë se sa popujt e tjerë të sotëm të Lindjes së Afërme, dhe se 29% e paraardhësve Armenë mund të rrjedhin nga një popullsi paraardhëse, që më mirë se kushdo tjetër përfaqësohet nga Europeanët Neolitikë. Më tej, rezultatet e tyre treguan që, “Armenët dhe popujt e tjerë gjenetikisht të izoluar të Lindjes së Afërme ndajnë prejardhje të përbashkët me fermerët (bujqit) e lashtë Europeanë në proporcione të ngjashme me atë të popujve Europeanë të ditëve të sotme, por jo me banorët aktualë të Lindjes së Afërme Testet tona treguan që shumica e këtyre afërsive të paraardhësve të Lindjes së Afërme, gjenetikisht të izoluar me Europeanët, mund t’i atribuohet zgjerimit pas periudhës Neolitike.”⁹⁸

Haak et al. (2015), sidoqoftë, pati një devijim interesant, duke pohuar se Hipoteza e Stepës mbështet së paku disa nga gjuhët Indo-Europiane, gjë që nuk e mohon Hipotezën Anatoliane, për më tepër e plotëson këtë të fundit, duke mbështetur më tej nocionin që Hipoteza e Stepës mund të shihet jo si një alternativë e Hipotezës Anatoliane, por si një rrugë kalimi drejt Europës. Njëkohësisht, është e rëndësishme të vihet në dukje se hipotezat Indo-Europiane të Gamkrelidzes dhe Ivanovit kanë gjetur mbështetje, duke mbështetur në këtë mënyrë indirekt pozicionin dhe rëndësinë e gjuhës Armene në këtë fushë parahistorike. Kjo mbështetje, praktikisht, erdhi nga të gjithë sektorët e kërkimit, duke përfshirë këtu zbulimet kërkimore të vetë atyre, publikimet monumentale të 1995, si edhe zbulimet nga Collin Renfrew, arkeologu Britanik, i cili ishte i pari që zhvilloi Hipotezën Anatoliane (Renfrew 1987, 1990, 2003), nga Gray, Atkinson dhe Greenhill (2011) dhe Gray dhe Atkinson (2003), ku analizimi nga ana e tyre e një

⁹⁸ *Shënim V. Setian*: Për më shumë sqarime mbi këtë çështje, shih: “Armenians Have a High Genetic Affinity to Ancient Europeans – New Study Reveals”.

matrice me 87 gjuhë me 2449 elemente gjuhësore prodhoi një shkallë vlerësimi të moshës të shfaqjes (shkëputjes) fillestare Indo-Europiane të ndodhur ndërmjet viteve 7800 dhe 9800 vjet BP.

Gjetjet e famshme të Gray dhe Atkinson (2003) u bënë më pas elektrizuese kur erdhën rezultatet nga Serva dhe Petroni (2008). Duke marrë parasysh teorinë e zbatueshmërisë së distancës të Levenshteinit në gjuhësi, Serva dhe Petroni krahasuan 50 gjuhë, që ndodheshin brenda pemës së gjuhëve Indo-Europiane. Rezultatet e tyre e mbështetën akoma më tej Hipotezën Anatoliane me disa pak kontraste interesante. Në kontrast me grupimin që i bënë Gray dhe Atkinson gjuhës Armene dhe asaj Greke duke i vendosur në një degë të veçantë, Serva dhe Petroni e trajtuan gjuhën Armene si një degë fare më vete, shumë pranë rrënjës, ndërsa dega tjetër - si degë që përmbante të gjitha gjuhët e tjera Indo-Europiane të mbetura. Për më tepër, rezultatet e tyre e vendosën gjuhën Greke në fazën fillestare të ndarjes, duke vendosur, gjithashtu, gjuhën Shqipe si pjesë e gjuhëve Indo-Europiane në krahasim me pozicionimin Indo-Iranian të propozuar më parë nga Gray dhe Atkinson. Kështu, ata vendosën gjuhën Armene dhe pastaj atë Greke në rradhën e atyre që u shkëputën fillimisht nga pema e gjuhëve Indo-Europiane.

Arkeologët dhe antropologët e dinin që bujqësia u përhap nga Lindja e Mesme në Greqi, gjë të cilën zhvilluesit fillestarë të Hipotezës Anatoliane e konsideruan si pjesë të një perspektive më të vonë. Renfrew argumentoi që bujqit mund të kishin lëvizur nga Anatolia për në Europë, duke sjellë me vete njohuritë bujqësore dhe fjalët që kishin lidhje me to, afërsisht 8500 vjet më parë. Zbutja e kafshëve për përdorim për nevoja shtëpiake, praktikat bujqësore dhe agrikultura ishin të ndërthurura në Malësitë Armene. Për shembull, dukuritë sugjerojnë që këta agrikultorë/fermerë i zbutën kafshët dhe njera prej tyre ishte “*cow*” – *kau* (transkript) – lopa (Shqip), të cilën ata e thërritën “*gwou*” – *kou* (transkript) - lopa (Shqip). Fjala “*kov*” mund të gjendet në Armenisht, dhe “*govse*” – lopë në Finlandën Veriore, Norvegji dhe Suedi. Këta fermerë kishin, gjithashtu, një mjet të quajtur

“ara”. Është pranuar, që fjala Latine për *“plugoj, çaj tokën, hap brazda”* është *“arable”* dhe ka lidhje me fjalën Angleze *“arable”*, që ka kuptimin “diçka që është e aftë për t’u kultivuar”. Në gjuhën Armene *“ararel”* ka kuptimin “me bë, me krijue”, dhe *“arariç”* përkthehet “krijues”. Për më tepër, fjala rrënjë *“ar”* përmbahet në mijëra fjalë Armene, të cilat e kanë rrënjën *“ar”* në fillim, në mes ose në fund të fjalës, më shpesh se në çdo gjuhë tjetër, që përmban tingullin e këtyre dy germave, por që shprehin kuptimin prapa konceptit ose ideve që lidhen me *“ar”*.

Emri është i lidhur me rrënjën etimologjike Indo-Europiane – *“ar”*, që ka kuptimin e “grumbulli” ose “krijimi”, i cili lidhet me “dritën”, “zjarrin”, “fisnikërinë”, “fuqinë” dhe “diellin” të gjetur në një numër të madh emrash Armenë dhe vendesh duke përfshirë këtu *Ararat, airarat, Arta, Arsen, Artur, Artak, Arian, Aratta*, dhe *Armenia*. Nalbandiani (1974) shton, “rrënja *Arat-Urat, Ar-Ur*, ka qenë ripërsëritur për të marrë formën e shumësit *Arar* (akoma edhe tani në fjalorin Armen në përdorimin në të folur *“Arar ashkhar”* – komuniteti Arian, d.m.th. Populli-Ar). *“Arar”* më pas është pajisur me prapashtesën *–at* për të krijuar emrat e tokës dhe malit Ararat, ndërkohë që kombinimi i parregullt i *“ur”* me *“ar”* ka prodhuar formën e shumësit *“urar”*, i cili, më pas i pajisur me prapashtesën *–tu* ka prodhuar emrin e tokës (vendit) *Urartu* (fq. 6). Kjo rrënjë etimologjike është gjetur, gjithashtu, në Irlandë, gjë që është analizuar nga Adolf Piktet (Adolphe Pictet) në fundin e shekullit të 19^{te}, duke hapur kështu një kapitull të tijin në studimin e ngjashmërive Armeno-Kelte.

Renfrew besonte se vetëm një origjinë Anatoliane mund të shpjegonte përhapjen simultane të gjuhës Proto-Indo-Europiane nga Lindja në Perëndim, dhe i vetmi motorr socio-teknologjik mjaft i fuqishëm për të shtyrë gjuhën aq larg në drejtime diametralisht të kundërta ka qenë futja e agrikulturës, e cila u shfaq pikërisht në jug dhe në lindje të Turqisë së sotme - afërsisht 11 000 vjet më parë. “Nëqoftëse dëshironit një teori të thjeshtë për shfaqjen e gjuhëve Indo-Europiane, epoka Neolitike është gjëja më e mirë mbi të cilën mund të mbështetemi” (Renfrew, 1994). Në vitin 2000, Renfrew vërtetoi

më tej pozicionin e tij fillestar, duke pozuar më tej që përdorimi për nevoja shtëpiake e elementeve bazë siç është gruri, bagëtia, elbi, delet, etj, u shoqërua me përhapjen e gjuhës PIE (Proto-Indo-Europian) nga Anatolia në Europë, tezë të cilën e mbështeti fort edhe Diamond (1997). Ashtu siç kishte deklaruar edhe Aleksandër A. Varbedian, si rezultat i studimeve të tija të zgjeruara, “ ... Malësitë Armene u bënë i vetmi vend i mundshëm i *Vullkanit Neolitik*, një deklaratë, që vazhdon të mbetet e padiskutueshme për një kohë kaq të gjatë. Për më tepër pranëvënia (ballafaqimi) e teorive të vjetra dhe atyre të reja na vjen në ndihmë për ta provuar këtë” (fq. 559, Genesis - Aya). Johannes Krause, një arkeologo-gjenetist Gjerman, drejtor në Institutin Maks Plankt për Historinë Njerëzore në Jena të Gjermanisë, ku ai ka qenë edhe një nga antarët themelues, dhe një nga drejtuesit e Departamentit Arkeologo-Gjenetik, gjeti se revolucioni Neolitik, i cili përmbante elemente gjenetikë, kulturorë dhe gjuhësorë, me prejardhje (që vinte) nga Lindja e Afërme, që përfshinte “Anatolinë” dhe “Malësitë Armene”, influençoi në kalimin nga statusi i njeriut gjahtar dhe grumbullues në një civilizim më të strukturuar, duke kaluar në zbutjen e kafshëve për nevoja shtëpiake dhe punimin e tokës, gjë që influençoi në pjesën tjetër të Europës⁹⁹.

Shumë nga çështjet paraprake lidhur me studimet Indo-Europiane u ngritën nga njerëz si Gerardi i Uellsit (Gerard of Wales) (1146-1223), Xhorxh Bukanan (George Buchanan) (1506-1582), Filippo Sasseti (1540-1588) dhe Marcus Zuerlus van Boxhorn (Boks’horn) (1612-1653), të cilët ishin të parët që filluan të analizojnë ngjashmëritë ndërmjet gjuhëve të Europës e më gjerë. Ata ishin të tërhequr dhe më të preokupuar nga njohja e gjuhëve, të cilët ata nuk mund t’i kuptonin, se sa të ishin të arsyeshëm të kuptonin se çfarë po analizonin dhe si t’i vendosnin këto gjuhë në kornizën e duhur kohore dhe në lidhje me njera tjetrën. Vrojtimet fillestare të Sassetit çuan në zbulimin e

⁹⁹ *Shënim V. Setian*: “Genetic Differences of Modern Europeans”. Johannes Krause. Shih Lazaridis et al. (2014).

mëpasshëm të pemës Indo-Europiane të gjuhëve, por njëkohësisht, vërejtja e tij lidhur me lidhjen ndërmjet gjuhës Sanskrite dhe asaj Italiane krijoi një dezinformatë të mundshme, e cila influenoi për një kohë të gjatë, aq sa gjuha Indiane, që ishte vendlindja e gjuhës Indo-Europiane, u hoq nga marrja e mëtejshme në konsideratë¹⁰⁰.

Vërejtja e Sassetit influenoi në qarqe të ndryshme akademike duke përfshirë edhe punimet e Keneth Chandler, PhD, në veprën e tij “Origjinat e Civilizimit Vedik”. Ai deklaroi se popujt, që nuk e shohin civilizimin Vedik si të lindur pa influenca të jashtme, kanë hipoteza të tjera, siç është “forma e hershme e Sanskritishtes u rrit në Indinë Veriore, dhe që disa banorë të Indisë veriore migruan në perëndim në zonën e Detit të Zi, ku gjuha e tyre u transformua në Anatoliane, Armene, Kelte dhe Greke” (fq. 14).¹⁰¹ Me fjalë të tjera, ai është duke thënë edhe që kultura Vedike ka lindur pa influenca të jashtme, siç është ajo Indo-Europiane, si edhe njëkohësisht, ai ofron një hipotezë tjetër, që nuk është e vetja por e të tjerëve, që janë po aq të çuditshëm. Pa takimin e Indisë veriore me Arianët, ne nuk do të mund të flisnim sot për civilizimin Vedik, që njohim sot, dhe natyrisht, Rig Vedat ilustronjë qartë terrenin¹⁰², i cili nuk ka lidhje me Luginën e Indusit. Për më tepër, popullsia e Indisë Veriore ka një përbërje gjenetike dhe fenotipike* shumë më të ndryshme, se sa ajo e pjesës jugore, gjë që është një tjetër tregues i migrimëve Ariane në pjesën e sipërme të Indisë, ashtu siç tregohet edhe në Rig Vedat.

Kontrolli dhe ballafaqimi janë një domosdoshmëri në Akademi. Asnjë çështje nuk është e imunizuar nga shqyrtimi dhe kërkohet vetëm

¹⁰⁰ *Shënim V. Setian*: Përmendur në Gullberg J. (1997). *Mathematics: From Birth of Numbers*.

¹⁰² *Shënim V. Setian*: Shih: Witzel M. “Emrat Arianë dhe jo-Arianë në Indinë Vedike. Të dhëna për situatën gjuhësore, fq. 1900-500 B.C.” – Harvard University.

*Shënim B.P.: phenotypic = relating to the observable characteristics of an individual resulting from the interaction of its genotype with the environment = në lidhje me karakteristikat e vëzhguara të një individi që vijnë nga ndërveprimi i gjenotipit të tij me mjedisin.

një mundësi që pretendimet të marrin e të qëndrojnë në meritat e tyre. Nëqoftëse jo, atëhere çështja, potencialisht, i ngjan një treni në ecje e sipër. Arsyeja e parë përse shembujt e mësipërm duhet të dalin në dritë është për të ilustruar se si ndryshon informacioni nga njera fushë në tjetrën, ndërkohë që antarët aspak dyshues të auditorit e përthithin atë shqetësim apo konsideratë. Ne u kemi dallë ballas shumë opinioneve rreth këtyre temave, por ne duhet të jemi të aftë dhe në gjendje të dallojmë se kush është e vërtetë në mënyrë të arsyetuar dhe çfarë mund të jetë jo e vërtetë, pa qenë vazhdimisht të shtyrë apo tërhequr nga të dhëna që qarkullojnë e riciklohen vazhdimisht.

PËRFUNDIM

Natyrisht, ka popuj primitivë në vendet Baske, të cilët mërmërisin gjuhë primitive, siç ndodhte në të gjithë Gadishullin Iberik, siç janë edhe Ligurianët apo Tartesianët, ose Keltët, ose “Malagenjos” (Malaguenos) nga shpellat Nerja; por trangu i korpusit gjuhësor të Spanjës Veriore dhe Francës jugperëndimore është gjuha Armene, që tashmë quhet “Baskishte”, me shtesa të ndikimeve të gjuhëve Romane, tashmë fqinje me të, në gjuhën Baske, të cilën gjuhëtarët profesionistë e quajnë shtresë (Stratum), e cila ka lënë kaq shumë gjurmë në dialektet e shumta të luginave Baske”. – Jesus Garcia Castrillo¹⁰³

Ndonjeri mund të mendojë që fusha e kërkimeve mbi këtë çështje nuk do të kishte heshtje të dyshimta mbi ngjashmëritë përfundimtare (përcaktuese) ndërmjet gjuhës Baske dhe asaj Armene. Probabiliteti statistikor, që thjesht një shans apo një koincidence e vetme të mund të shërbejë si shpjegim për shqiptimin (tingëllimin) e njëlojtë të fjalëve të ngjashme Basko – Armene, dhe që njëkohësisht të kenë të njëjtin kuptim, do të ishte i pakuptimtë (absurd). Nga ngjashmëritë e dukshme të fjalëve ne mund të arrijmë në përfundimin e afërsisë (bashkësisë) ndërmjet tyre, përtej çdo dyshimi të arsyeshem dhe të përfytyrueshem. Përsëri, për një moment përfytyroni se sa e papranueshme do të ishte mundësia e një koincidence ndërmjet gjithë këtyre dukurive të paraqitura.

¹⁰³ *Shënim V. Setian*: Publikuar elektronikisht në 29 Korrik 2013.

Për sa ngjashmëri të sakta kemi ne nevojë për të ndryshuar këto shoqërime (afërsi, bashkësi) nga të qëniet marrëdhënie rastësore në të qëniet marrëdhënie jo-rastësore? Qartësisht, ne shohim shkallët e shoqërimeve (e afërsive, bashkësive) që trondisin skepticizmin dhe çështja është se këto shoqërime nuk janë përmendur në punimet e Traskut ose të të tjerëve, që bëjnë pjesë në rrethin e tij miqësor. Ne nuk jemi duke krahasuar dy terma që nuk kanë lidhje ndërmjet tyre, por dy terma, që janë duke shprehur drejtpërdrejt një vëzhgim (trajtim, vrojtim) të të njëjtit koncept. Prania e e përdorimit të fjalëve të ngjashme ndërmjet gjuhës Armene dhe asaj Baske është e qartë, e dukshme dhe e verifikueshme.

Marrja në konsideratë e gjuhës si element kyç për të zbrërthyer të shkuarën ndërmjet Armenisë dhe Baskëve është e pashmangshme, gjë që mbështet më tej pohimin e Ellis (1861), që thotë se: “prova më e madhe nga të gjitha është prova e gjuhës”. Shmangia e dukurive, në disa raste mund të konsiderohet e paqëllimshme, por në raste të tjera, siç ka rezultuar, është qartësisht e qëllimshme. Përfundimisht, duhet të kuptojmë, që raste të tilla të mosparaqitjes (apo mos marrjes në shqyrtim) të provave në akademi nuk janë raste të izoluar, por në të vërtetë pushtim i faqeve të revistave akademike. Pasja e një numri sa më të madh fjalësh dhe toponimish të ngjashme ndërmjet gjuhës Baske dhe asaj Armene do të ishte thelbësore për të gjithë për të rishqyrtuar këto shoqërime (afërsi, bashkësi) të pamohueshme dhe për të synuar mbushjen e boshllëqeve në njohuritë tona. A është e mundur që vrojtimi i Ellis se “çfarëdo ngjashmëri Armene që gjendet në Europë duhet të jetë e një hyrjeje shumë të hershme: Pasi asnjë pushtim apo migrim Armen nuk mund të jetë bërë kaq thellë në perëndim, me përjashtim të rastit kur kjo mund të ketë ndodhur në kohërat parahistorike, ose mbase edhe në kohërat para-tradicionale ...” të mund të konsiderohet si një element tjetër kritik që zgjidh një çështje kritike? Pyetja se përse ne shohim ngjashmëri ndërmjet gjuhës Armene dhe të gjuhëve të tjera nëpër botë, si ato të vdekura ashtu edhe ato aktualisht të gjalla, mund të na tregojë neve se i njëjti

grup migrator guxoi të largohej në drejtim të pjesëve të tjera të botës, duke marrë me vete njohuritë e veta mbi agrikulturën, zbutjen e kafshëve shtëpiake dhe shumë element të dorës së parë të civilizimit, të mbështjella (të ruajtura) me gjuhën e tyre. Osip Mandelstam, në shkrimin “Udhëtim në Armeni”, u shpreh se “gjuha Armene nuk mund të konsumohet; çizmet e saj janë prej guri. Po, sigurisht, fjalë të ngulitura në mure të trashë, me shtresa ajri në gjysmë-zanoret”. I njëjti fill i artë përshkon si gjuhën Baske ashtu edhe atë Armene dhe është e shkuara e largët që i lidh të dyja gjuhët. Ne mund të pyesim veten se si është e mundur që termat *Armenia*, *Ararat*, *Araler* dhe *Araks* kanë hyrë në legjendat dhe tregimet folklorike të popullit Bask në botën e sotme, ku është shumë më e përshtatshme dhe e arsyeshme, që ky fenomen të shihet si një kontribut i lashtë që nga kohë, që nuk mbahen mend?

Duket sikur me këtë ne kemi kaluar pengesën, që na siguronte provën pohuese të ngjashmërive të gjuhës Baske me atë Armene. Ne tashmë jemi duke punuar më tepër për të zgjidhur problemin se *kur* ndodhi takimi i gjuhëve ndërmjet tyre, ose, nga ana tjetër, të hetojmë nëse ndonjë grup i veçantë entogjuhësor kuturisi të largohet nga Malësitë Armene në drejtim të tokave Baske në të shkuarën e largët. Ajo që na zbulojnë dukuritë është fakti që kontakti i gjuhëve ose nëqoftëse pranojmë idenë e emigrimit të Baskëve nga Malësitë Armene, duhet të ketë ndodhur në kohë të lashta. Shtresa Armene brenda kulturës dhe gjuhës Baske është shumë e vjetër, dhe e mbuluar me shtresa të reja në sipërfaqe të influencave relativisht të reja (p.sh. me influenca të gjuhës Latine, ose të vendeve fqinje), siç mund të gjejmë normalisht edhe në kërkime të tjera të fushës së paleontologjisë apo gjeologjisë. Të tjerët pajtohen me këtë nocion, përfshirë këtu edhe Varbedianin, i cili pohon se ata që erdhën në ishull sollën me vete emrat dhe toponimet e tyre fisnorë vendas, siç është emri, p.sh. Basank, ai që lidh Baskët me krahinën Armene të Basenit, një provincë e Araratit.

Afërsia Basko-Armene është gjithashtu historike, duke marrë

parasysh që si malësorët Armenë ashtu edhe Baskët janë metalshkrirës të shquar.¹⁰⁴ Në të dy këto vende, në periudhën e paraKrishterë, muaji i dytë i vitit quhej *Urri* për Baskët dhe *Hori* për Armenët. Në gjuhën Baske ari (floriri) quhej “urea”, gjë që na çon drejt një hipoteze interesante. Krahina Hurri-Mitani dhe Mbretëria Armene e Mitanit¹⁰⁵ kanë qenë të njohura për metalurgjinë e tyre të zhvilluar, krahas arritjeve në fusha të tjera. Një informacion kritik për të vënë në dukje është fakti që kryeqyteti i Mitanit ishte Waššukani (Uaššukani, Vaššukani), ku akoma edhe sot Armenët e mbajnë emrin Vaçagan dhe e përdorin si emër njeriu. Për më tepër, një nga qytetet kryesore të Mitanit ka qenë quajtur Haran. Siç është përmendur, *aran* quhet një zonë në Armeni, ndërkohë që një zonë në Katalonia të Spanjës quhet *Lugina Aran* (Val d’Aran), që është e prejardhur nga fjala Baske “*aran*” që do të thotë “*luginë*”. Duke marrë parasysh që si malësorët Armenë ashtu edhe Baskët kanë qenë njohur për mjeshtërinë e tyre metalurgjike, ka shumë të ngjarë që grupi i njerëzve nga Malësitë Armene, të cilët kuturisën të shkojnë në zonat Baske, duke u vendosur në Pirenejtë, të ketë ndodhur gjatë kësaj periudhe. Ky supozim mund të na sqarojë neve përse Baskët përdorin fjalën “*urea*” për të treguar “arin, floririn”, një arsye e mundshme kjo përse në Hurri-Mitani, duke qenë qendra e metalurgjisë dhe e shkrirjes së metalit, emri i krahinës u përdor si emër për “arin, floririn” në krahinat Baske. Natyrisht, “*urrea*” është shumë i afërm me Latinishten “*aurum*”, ku prapashtesa “*um*” i është shtuar “*aur*”. Kjo hedh dritë mbi idenë Baske se ata (të ardhurit) janë mbartës të një gjuhe të “artë”. Kështu, përse i përket tezës nëse Baskët janë banorë vendas të zonës apo jo, unë argumentoj se ata ose duhet të kenë qenë në kontakt me gjuhën

¹⁰⁴ *Shënim V. Setian*: Në Armeninë e lashtë, që tashmë është pjesë e Turqisë moderne juglindore, janë gjetur shpata 5 500 vjeçare. Ato janë prodhuar me tehun dhe dorezën njëcopëshe, të veshura sipër me argjend. Gjatë procesit të farkëtimit është përdorur arsenik, si element veprues për të rritur fortësinë e metalit.

¹⁰⁵ *Shënim V. Setian*: Mitani ka qenë një çështje e nxehtë (shumë e diskutuar) në Britani në shekullin e 19^{te}.

Armene gjatë kohërave parahistorike, ose Baskët kanë qenë një degë e ndonjë klani Armen, e cila guxoi të ndërrmarë një emigrim të tillë për në këto vende (për në vendet Baske) përgjatë kohëve të lashta, të afërta me ato të periudhës Hurri-Mitani.

Ky dorëshkrim tashmë e ka kryer detyrën e pajisjes së lexuesit me tabllonë, që i nevojitet për të parë ngjashmëritë ndërmjet gjuhës Baske dhe asaj Armene, gjuha e dy jehonave të lashta të dala nga një zë parahistorik i përbashkët (i vetëm). Gjithashtu ishte në gjendje të ilustronte mungesën e dyshimtë të të dhënave të tilla kritike nga rryma kryesore akademike, madje edhe prej atyre, të cilët duhej ta kishin ditur mirë. Është zbuluar, gjithashtu, edhe fakti se si gjuha Armene nuk është e pranishme vetëm brenda shtresës së vjetër të gjuhës Baske, por prania e saj ndjehet në shumë gjuhë në mbarë botën me konkuzionin llogjik që kontakte të tilla ndërmjet gjuhëve respektive duhet të kenë ndodhur përgjatë kohëve para-historike dhe para-tradicionale. Nëqoftëse Baskët janë një popull i vjetër, ashtu si edhe Armenët, dhe toponimitë Baske reflektojnë një shtresë Armene, atëhere kjo shtresë duhet të jetë kaq e vjetër, sa të marrë mijëra vjet për t'u shndërruar në legjendë në tregimet folklorike Baske. Në këtë ekuacion ne nuk mund të heqim kalimin e kohës, izolimin dhe harresën historike. Mbi të gjitha, madje edhe vetë e njëjta gjuhë me dy dialekte të ndryshme nuk mund ta kuptojë vetveten kur kalon gardhin që i ndan. A nuk është e jashtëzakonshme, që ndonëse ka kaluar një kohë kaq e gjatë, ne jemi akoma të aftë të dëgjojmë diçka unike të dallueshme ndërmjet dy degëve të një gjuhe të lashtë? Kjo duhet të rivendosë dhe të përforcojë lidhjen midis kërkuesve në mbarë globin për të tërhequr vëmendjen e tyre në këtë temë thelbësore, duke ringjallur materialin e kaluar, që është zhvilluar pa u lodhur e me ndërgjegje nga studiues të ndërgjegjshëm. Unë shpresoj, që lexuesi do të arrijë të kuptojë se ajo, që është e pranishme në rrymën kryesore akademike, mund të ketë pjesë, që mungojnë në ekuacion. Tashmë duhet të jetë shqetësuese për ne që gjuha Armene dhe “Urartian”, si edhe Armene dhe Baske, kanë jashtëzakonisht shumë elemente të ngjashëm ndërmjet tyre se

sa me çdo gjuhë tjetër, por në njëfarë mënyre, statistika të tilla kritike mungojnë. Zgjidhjet nëse gjuha Armene dhe ajo Baske kanë lidhje me njera tjetrën janë shumë më të thjeshta për t'u zbuluar, se sa ato që na janë paraqitur nga rrymat kryesore akademike si një zgjidhje “praktike”. Përkundrazi, ato nxjerrin në sipërfaqe probleme jologjike, dhe logjika është një nga elementet më të rëndësishme, që është përdorur në mënyrë të pamjaftueshme në kërkimet gjuhësore dhe ato historike.

Një nga çështjet kryesore brenda gjuhësisë historike dhe krahasuese është të krahasuarit e një gjuhe të vjetër me një të ngjashmin e tij relativisht shumë më të ri, ndërkohë që është i ekspozuar ndaj gabimit në kronologjinë e influencave. Ne mund ta shohim këtë gabim shumë herë në ato raste, kur drejtimi i studimit është përmbysur, duke konsideruar gjuhë shumë më të reja sikur kanë influencuar mbi të vjetrat, ndërkohë që këto të vjetrat tashmë janë hequr fare nga i tërë ekuacioni. Ne mund ta konsiderojmë gjuhën Hittite, Armene, Egjyptiane, Kelte, Baske dhe Sumeriane si gjuhë të lashta, të cilat do të na lejojnë neve të analizojmë pjesën tjetër të gjuhëve Indo-Europiane dhe spektrin jo-Indo-Europian. Ne, thjesht, nuk mund ta analizojmë historinë e vjetër nëpërmjet izolimit të këtyre gjuhëve dhe civilizimeve, pasi ato janë të ndërvarura. Në të njëjtën kohë, ne jemi të paaftë ta heqim këtë ndërvarësi nga historia e lashtë dhe gjuhësia krahasuese dhe të presim që të mbajmë të paprekura themelet e kërkimit. Kjo nuk mund të ndodhë. Ne duhet të parashtrijmë pyetjet e duhura dhe në këtë mënyrë ne do të marrim përgjigjet e duhura, të cilat na japin më tepër informacion, vizion dhe perspektivë se sa shtrembërime dhe koklavitje. Përndryshe, ne jemi duke bërë padrejtësi në këtë fushë kërkimi dhe komprometojmë integritetin e së kaluarës sonë historike. Ky citim i shkurtër nga “Princi i Vogël”¹⁰⁶ shpreh nevojën tonë për të shtruar pyetjet e drejta dhe ka si qëllim perspektivën e duhur:

Figurat e dashura të të rriturve. Kur ju u tregoni atyre se ju keni bërë një mik të ri, ata kurrë nuk ju pyesin rreth çështjeve kryesore. Ata nuk ju thonë kurrë: “Si tingëllon zëri i tij? Cilën lojë pëlqen më tepër ai? A mbledh flutura ai?” Në vend të tyre ata kërkojnë të dinë:

“Ç’moshë ka? Sa vëllezër ka? Sa peshon? Sa para fiton i jati?” Mendoni ju, se vetëm prej këtyre përshkrimeve ata do të kenë mundur të mësojnë diçka rreth mikut tuaj?”

Për të pasur konkluzione më të qëndrueshme duhet që edhe pyetjet të jenë formuluar më drejt. Dikush nuk mund të pyesë “kush ishin Urartianët?” ose “çfarë gjuhe flisnin ata?” pa pasur ambientin e duhur për të arritur në konkluzione të arsyeshme. Në të njëjtën mënyrë, ne thjesht injorojmë ngjashmëritë e gjuhëve Basko-Armene dhe presim përfundime të shëndosha alternative. Konkluzione të duhura merren në kushte të duhura. Nëqoftëse këta akademikë do vazhdojnë të shkojnë pas popujve të tillë, që nuk kanë ekzistuar kurrë dhe arrijnë në përfundimin që gjuha është një formë tjetër e një dialekti Armen, atëhere ne do të mund t’i shohim ata që të mund t’i jenë afruar realitetit me pohimet dhe përfundimet e tyre. E njëjta perspektivë vlen edhe për ngjashmëritë ndërmjet gjuhës Armene dhe asaj Etruske. Ne mund të argumentojmë se gjuha Armene është një shtresë e vjetër mbi të cilën janë imponuar transformime të reja përgjatë kohës dhe kjo mund të zgjidhë misterin se përse gjuha Armene është gjetur në formën e saj të lashtë dhe në shumë gjuhë dhe civilizime të tjera të lashta. Me këtë shënim përmbyllës ne mund të marrim zemër, pasi ashtu si dielli nuk mund të fshihet pas reve, e vërteta nuk mund të mbulohet me vello.

DORËSHKRIMI I ARDHSHËM

Kërkimin e rradhës ne mund ta fillojmë duke pyetur se, kur ka ndodhur kontakti ndërmjet gjuhës Baske dhe asaj Armene, ka qenë një rrënjë që u nda në dy pjesë, dhe a do të mundte Portasar Temple (Göbekli Tepe)¹⁰⁷ të na jepte të dhëna për hetimin tonë? Në fund të fundit, gjuha është si gjurmë gishti dhe ne nuk duhet të lejojmë që udhëzime të ngurta dhe të fosilizuara, të cilat kanë vetë nevojë për rregullim të rreptë, të udhëheqin kërkesën tonë të çiltër për të studjuar të kaluarën antike

Ky kërkim i rradhës do të përbëjë publikimin tim të ardhshëm, dhe do të ketë të bëjë me ekzaminimin e kompleksit Portasar nga perspektiva e tij gjuhësore dhe mënyrës se si gjuhët Armene dhe Hittite mund të ndihmojnë ata, që përpiqen ta dëshifrojnë atë.

Unë besoj se kjo do të ketë mundësinë të ndikojë në gjuhësinë historike dhe atë krahasuese, dhe me shumë gjasa, të përfshijë edhe hulumtimet gjenetike dhe antropologjike. Pyetja e parë që ne mund të ngremë rreth kësaj çështjeje është, “cila ka qenë forma e gjuhës me të cilën njerëzit e lashtë komunikonin midis tyre dhe që mundësonte organizimin e shoqërisë njerëzore deri në atë shkallë zhvillimi të mjaftueshme për të bërë ndërtime të tilla siç janë tempujt e vjetër të zbuluar?” Por nëqoftëse ka pasur një tempull dhe një kompleks,

¹⁰⁷ *Shënim V. Setian*: Përcaktimi Turk është përkthimi i mirëfilltë nga Armenishtja, që do të thotë “mal detar” ose “mal kërhizor”.

atje me siguri duhet të ketë pasur edhe një shoqëri shumë aktive, që i përgjigjet atyre mijëra viteve të mëparshme, që përkojnë me ndërtimin e tyre.

[Shtojca 1]

TABELA 11: ALFABETI ARMEN

[Source : Encyclopedia Britannica]

	<u>1</u>	<u>2</u>	<u>3</u>		<u>1</u>	<u>2</u>	<u>3</u>
1	Ա	ա	a	13	Խ	խ	kh
2	Բ	բ	b	14	Ծ	ծ	ts
3	Գ	գ	g	15	Կ	կ	k
4	Դ	դ	d	16	Հ	հ	h
5	Ե	ե	e	17	Ձ	ձ	dz
6	Զ	զ	z	18	Ղ	ղ	gh
7	Է	է	ē	19	Ճ	ճ	ch
8	Ը	ը	ë	20	Մ	մ	m
9	Թ	թ	t ^h	21	ԅ	յ	y
10	Ժ	ժ	zh	22	Ն	ն	n
11	Ի	ի	i	23	Շ	շ	sh
12	Լ	լ	l	24	Ո	ո	o

Shënim B.P.: Shpjegimi i tabelës së mësipërme:

Nën numrin 1 janë vendosur gërmat e mëdha të Alfabetit Armen

Nën numrin 2 janë vendosur gërmat e vogla të Alfabetit Armen

Nën numrin 3 është vendosur transkripti ndërkombëtar i dialektit Armeno-Lindor

Kjo tabelë (Tabela 11) është shkëputur nga libri “Armenian Origins of Basque” i Vahan Setian (Fq. 86)

	1	2	3		1	2	3
25	Չ	չ	ch ^h	32	Ը	ը	r
26	Պ	պ	p	33	Յ	յ	ts ^h
27	Ջ	ջ	j	34	Ի	ի	w
28	Ռ	ռ	ř	35	Փ	փ	p ^h
29	Ս	ս	s	36	Ք	ք	k ^h
30	Վ	վ	v	37	Օ	օ	ō
31	Տ	տ	t	38	Ֆ	ֆ	f

[Shtojca 2]

ALFABETI ARMEN DHE TRANSKRIPTI

[Source : Encyclopedia Britannica]

	1	2	3	4	5
1	Ա	ա	ա	ա	ա
2	Բ	բ	բ	բ	բ
3	Գ	գ	գ	գ	գ
4	Դ	դ	դ	դ	դ
5	Ե	ե	ե	յե	յե
6	Զ	զ	զ	զ	զ
7	Է	է	ե̅	ե	ե
8	Ը	ը	ե̅	ե̅	ե̅
9	Թ	թ	տ ^h	տ	տ
10	Ճ	ճ	չհ	չհ	չհ
11	Ի	ի	ի	ի	ի
12	Լ	լ	լ	լ	լ
13	Խ	խ	կհ	հ	հ

Shënim B.P.: Shpjegimi i tabelës:

Nën numrin 1 janë vendosur germat e mëdha të Alfabetit Armen

Nën numrin 2 janë vendosur germat e vogla të Alfabetit Armen

Nën numrin 3 është vendosur transkripti ndërkombëtar i dialektit Armeno-Lindor

Nën numrin 4 është vendosur transkripti shqiptar i dialektit Armeno-Lindor

Nën numrin 5 është vendosur transkripti shqiptar i dialektit Armeno-Perëndimor

1	2	3	4	5	
14	Ծ	ծ	ts	c	x
15	Կ	կ	k	k	g
16	Հ	հ	h	h	h
17	Ձ	ձ	dz	x	c
18	Ղ	ղ	gh	gh	gh
19	Ճ	ճ	ch	ç	xh
20	Մ	մ	m	m	m
21	Ե	յ	y	j	j
22	Ն	ն	n	n	n
23	Շ	շ	sh	sh	sh
24	Ո	ո	o	vo	vo
25	Չ	չ	ch ^h	ç	ç
26	Պ	պ	p	p	b
27	Ջ	ջ	j	xh	ç
28	Ռ	ր	ր	rr	rr
29	Ս	ս	s	s	s
30	Վ	վ	v	v	v
31	Տ	տ	t	t	d
32	Ր	ր	r	r	r
33	Զ	զ	ts ^h	c	c
34	Ի	լ	w	hju	hju
35	Փ	փ	p ^h	p	p
36	Բ	բ	k ^h	k	k
37	Օ	օ	ō	o	o
38	Ֆ	ֆ	f	f	f

Shënim B.P.: Kjo tabelë është përpunimi i “Tabelës 11” (më saktë, plotësimi me transkriptimin nëpërmjet germave Shqipe), nxjerrë nga libri “Armenian Origins of Basque” i Vahan Setian (Fq. 86)

Hartë e krahinës Baske



Foto e marrë nga interneti

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Setyan, Vahan A.

Origjinat armene të baskëve / Vahan Setian ; përkth., përpun.
e përshtat. Berzh Piranjani. - Tiranë : Albpaper, 2020 ;
128 f. ; 14 x 21 cm.

Tit. origj.: Armenian origins of Basque

ISBN: 978-9928-05-268-1

1.Gjuha armene 2.Gjuha baske
3.Gjuhësia historike 4.Gjuhësia krahasuese

811.19 - 112

811.361 - 112

Lekë 500 Çmimi

